

❖ SPECIFIKIMET TEKNIKE

A. SPECIFIKIME TE PERGJITHESHME

A.1 SHENIME TE PERGJITHESHME

A.1.1 PERKUFIZIME

Përveç perkufizimeve në Klauzolat e Kushteve të Kontrates, janë në fuqi edhe perkufizimet që vijojnë.

Rruge do të thotë rruga ose rrjeti i rrugëve për të cilin janë kontraktuar Punimet dhe Sherbimet sipas Kontrates.

Zona e Rruges (Zona në pronesi e Rruges) do të thotë një zonë që mbulon hapësirën midis kufijve fundorë të seksionit tërthor rrugor (skaji i shpatullës, tehu i sipërm i anësës prerëse, tehu i kanalit të jashtëm), plus një meter majtas dhe djathtas.

Menaxheri i Rruges është një person (ose grup personash) i caktuar nga Autoriteti Kontraktor që është i ngarkuar të menaxhojë të gjithë aktivitetet sipas Kontrates. Ai është gjithashtu Perfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor për qëllimet e kësaj Kontrate. Në vazhdim të kësaj kontrate do të gjendet i shënuar në keto terma të barazvlefshëm **Menaxheri, Menaxheri i Rruges ose Menaxheri i Projektit, etj.**

Sherbimet janë të gjitha nderhyrjet në rrugë sipas Kontrates dhe të gjitha aktivitetet që lidhen me menaxhimin dhe vlerësimin e kushteve të rruges që do kryhen nga Kontraktuesi me qëllim arritjen e dhe mbajtjen e Standarteve Punuese të Rruges sic përcaktohet nga Nivelet e Cilesise se Sherbimit dhe marrjen e pageses së plote e tarifës mujore sipas Kontrates.

Nivelet e Cilesise se Sherbimit janë standarte të kerkuara punimesh të përcaktuara tek Specifikimet të cilat Kontraktuesi do i përmbahet gjatë zbatimit të Kontrates.

Punimet Emergjente është një komplet aktivitetesh të nevojshme dhe mjaftueshme për të ndrequr Rrugen dhe rindertuar strukturën e saj apo rripin në zonën në pronesi të rruges të demtuar si rezultat i fenomeneve natyrore me pasoja të pa parashikueshme, si stuhi të fuqishme, permbytje, dhe termete.

A.1.2 MIREMBAJTJA E BAZUAR NE EFEKTIVITET

Tipi standart i kontrates së inxhinierisë së ndërtimit është ajo me masë njësi me sasi punimesh të vlerësuara të bazuara në një projekt dhe në një cmim njësi për të kryer sasitë e vlerësuara sipas çdo zeri pagese.

Kontratat e bazuara ne efektivitet paraqesin nje tip me te avancuar kontraktimi kryesisht per perdorim ne kontraktime mirembajtjeje dhe ne kontrata tip BOT dhe bazohen ne cka kerkojne ne fund perdoruesit, qe d.m.th. nivele standarte te caktuara fillimisht me pagesa te bazuara ne shuma vjetore apo mujore ne total te plotesojne keto standarte.

Veshtiresite ne llogaritjen e e rreziqeve, sidoqofte, kane rezultuar ne kontrata hibride, ku kerkesat e specifikuara bazohen ne nivele standarte ose efektiviteti por pagesa bazohet ne cmime njesi me ose pa stimuj.

A.1.3 VECANTI E KESAJ KONTRATE

Mirembajtja e nje rrjeti rrugesh perfshin detyra periodike dhe rutine.

Mirembajtja rutine konsiston ne shume detyra te ndryshme per tu kryer shpesh per te mbajtur funksionin e rruges (si riparimet e gropezave,riparimet e mureve te betoni/gurit, pastrimin e drenimeve, vulosjen e te carave, shkuljen e barerave,riparimet/vendosjen e sinjalitikes etj.).

Mirembajtje periodike konsiston ne masa te parashikueshme dhe me te kushtueshme te nje natyre me te rralle te projektuara per te shmangur degradimin e rruges (si asfaltimi i shtresave te asfalto-betonit, etj.).

A.2 RREGULLA MATJEJE DHE PAGESA

A.2.1 RREGULLA TE PERGJITHESHME

Kontraktori do paguhet cdo muaj ne perputhje me Certifikaten Mujore te Pagesave qe firmoset nga Kontraktori dhe vertetohet nga Menaxheri i Projektit. Certifikata do perfshije nje sigurim nga Kontraktori qe ai ka qene ne pajtim me nivelet e sherbimit dhe cilesine e punimeve te specifikuar sipas Kontrates. Pagesa do bazohet ne sasite dhe cmimet njesi ne Preventiv, duke perfshire duke perfshire cfaredo pagese ne shume fikse dhe pagese per dite pune. Kerkesat per pagesa do shoqerohen nga dokumentacion mbeshtetes dhe raporti verifikues i vete-kontrollit i permendur ne seksionin A.3, Inspektime dhe Prova.

Cmimet e specifikuara ne Preventiv gjithashtu do mbulojne kostot e punimeve te pergjitheshme dhe lehtesirat ne perputhje me Dokumentat e Kontrates, dhe te cilat nuk jane te specifikisht te paraqitura ne Preventiv.

Pagesa perfshin verifikime dhe raportime, per te gjitha pagesat, te gjitha provat, sic specifikohet ne Dokumentet e Kontrates.

Nese nuk eshte thene ndryshe, puna do matet dhe shperblehet me njesite e specifikuara ne preventiv.

Nese niveli i cilesise se sherbimit apo cilesia e punimit te specifikuar nuk arrihet, pagesat pakesohen, bazuar ne nje liste ne kapitullin A.5, Gjobat per Vonesa tek Specifikimet.

Menaxheri i Projektit mund edhe te zbrese sasite dhe shumate qe lidhen me punen, qe sipas opinionit te tij, nuk eshte kryer me profesionalizem dhe duhet ribere. Ky vendim do regjistrohet ne Raportin e Perbashket Verifikues bashke me nje motivim te hollesishem. Pagesat nuk mund te ndalohen per gjera te pa pikepyetura.

A.2.2 PAGESAT ME BAZE EFEKTIVITETIN

Pagesat me baze efektivitetin jane te pa rregullueshme dhe i referohen shperblimeve mujore.

Pagesa do mbuloje te gjitha kostot per pune funksion te arritur plotesisht ose punim te perfunduar ne kuptimin e plote te Dokumentave te Kontrates. Zeri i pagese do perfshije te gjitha kostot per burimet dhe operacionet e kerkuara qe nevojiten per te mbajtur vetite funksionale dhe duke mbajtur ne mend te gjitha pengesat/kufizimet ne punime sipas Dokumenteve te Kontrates.

Per rrjedhoje, ato do perfshijne te gjitha kostot per mbikqyrje, administrime dhe interesa te tjera, si edhe pagen e Kontraktorit.

Verifikimi i punimeve te bazuara ne efektivitet do behet ne bazen e nje inspektimi qe do kryhet nje here ne muaj ne rruge.

A.2.3 PAGESAT NE CMIME NJESI

Pagesat ne cmime njesi jane pagesat per punime te rregullueshme bazuar ne sasite aktuale te kryera.

Rregullat ne vijim per Matjet dhe Shperblimet do perdoren per punimet e rregullueshme nese nuk bihet dakord ndryshe:

- Menaxheri ruan te drejten te beje rivendosje midis zerave te ndryshem te pageses.
- Kontraktori do sipermarre te kryeje punime qe korrespondojne zerave te pageses te specifikuar ne Preventiv.
- Pagesa do te paguhet ne perputhje me cmimi njesi te specifikuar ne Preventiv per njesine qe eshte specifikuar, dhe sipas sasise aktuale, nese nuk eshte shenuar ndryshe per zerin e pagese ne Specifikimet.
- Cmimet ne Preventiv do mbulojne te gjitha kostot per funksionet e specifikuar plotesisht te arritura ose punime te perfunduara ne kuptimin e plote te Dokumentave te Kontrates. Zeri i caktuar i pagese do perfshije te gjitha kostot per burimet dhe operacionet e kerkuara per masat e specifikuar me qellim mbajtjen e vetive funksionale dhe duke mbajtur ne mend te gjitha pengesat/kufizimet ne punime sipas Dokumenteve te Kontrates.
- Gjithashtu, duhet menduar per tu perfshire ne cmimin njesi, kostot e punimeve dhe sipermarrjeve ne perputhje me kete Kontrate, qe nuk jane te permendura posacerisht ne Specifikimet por qe kerkohen per te arrire funksionin ose zgjidhjen teknike te kerkuar.
- Verifikimi i cilesise dhe sasise te punimeve te kryera do kryhet menjehere me plotesimin e punimeve. Verifikimet do mbyllen ne Certifikatat Mujore te pageses.

A.2.4 DITEPUNE

Per punimet ditore ne listen e cmimeve do perdoren burimet e normuara gjate gjithë oreve te dites dhe nates. Lista cmimeve mund edhe te perfshije cmime njesi qe mbulojne zerat kryesore te pagesave per mirembajtje te renda.

Per punime te shpejta, dhe punime te tjera ndryshimi dhe shtese, Pagesa do paguhet ne perputhje me listen e cmimeve te burimeve, nese nuk thuhet ndryshe.

A.3 INSPEKTIMET DHE PROVAT

Kontraktori do kryeje inspektime te nivelit te sherbimit ne rrjetin e rrugeve qe perfshijne gjithë aspektet qe mund te vleresohen me metoda te thjeshta, si inspektimet pamore dhe matjet e thjeshta qe nuk kerkojne pajisje komplekse. Cdo inspektim do dokumentohet nga nje raport i shkurter qe perfshin informacionin e detajuar ne paragrafin A.8.1. Inspektimet do perfshijne bashke, kontroll dhe raportim mbi kushtet rrugore qe lidhen me zerat e kontraktuar sipas nje pagese njesi mujore.

Tabela A.3 tregon shpeshtesine e kerkuar te inspektimit te rrugeve per nivelin e arritur te sherbimit per rrjetin e rrugeve subjekt i kesaj Kontrate (Zerat e paguar me pagesa mujore).

Tabela A.3

| | |
|---|-----------------------------------|
| Kategorite e Mirembajtjes se Rrugeve | Rruget (te asfaltuara) |
| Shpeshtesia e Inspektimit te Rrugeve | 1/Jave |

Menaxheri i projektit mund te kryeje inspektime joformale te niveleve te cilesise se sherbimit. Ai mund te kryeje inspektime joformale me nismen e vet, ne cdo kohe dhe ne cfaredo seksioni rruge qe perfshihet ne Kontrate. Menaxheri i Projektit do perdore burimet e tij per ato inspektime. Nese ai dallon cfaredo seksioni ku nivelet e cilesise se sherbimit nuk jane arritur, ai eshte i detyruar te informoje Kontraktorin brenda 24 oreve me shkrim, me qellim qe ai te mund te marre veprime ndreqese se me shpejt. Rezultatet e inspektimeve informale nuk do perdoren nga Menaxheri i Projektit per te korrigjuar Certifikatat Pagesore Mujore te Kontraktuesit ose per te aplikuar Zbritje Pagesash/Gjoba Demesh, me perjashtim te rasteve kur rruga ka qene plotesisht e nderprere dhe keshtu nuk eshte plotesuar kriteri i Perdorueshmerise se Rruges. Pavaresisht nga sa me siper njoftimi si i tille eshte formal dhe Kontraktori duhet ti permbahet kufijve kohore specifikuar me poshte ne kapitullin B2.

Kontraktori do vendose, brenda struktures se tij organizative, nje **Njesi Vete-Kontrolli** te vacante te plotesuar me personel te kualifikuar, detyra e te cilit eshte te monitoroje dhe mbeshtese verifikimin e shkalles se perputhjes me Nivelet e Cilesise se Sherbimit. Njesi e Vete-Kontrollit gjithashtu do kryeje ose organizoje prova dhe matje; pergatise, paraqese dhe dorezoje tek Menaxheri i Rruges gjithë informacionin me qellim krijimin e dokumentacionit te percaktuar ne Specifikimet dhe manexhimin dhe mirembajtjen efektive te rrugeve. Njesia e vete-kontrollit do kryeje gjithashtu ose monitoroje, ne bashkepunim te ngushte me Menaxherin e Projektit, verifikimet mbi Nivelet e Cilesise se Sherbimit.

A.4 VERIFIKIMET

Niveli i arritur i cilesise se sherbimit do verifikohet nepermjet Inspektimit te Perbashket nga Menaxheri i Projektit dhe Kontraktori. Inspektimi i Perbashket do kryhet nje here ne muaj dhe do jete baza per vertetimin nga Menaxheri i Projektit te raporteve mujore, pra inspektimet perbejne vleresimin e punimeve te kryera.

Inspektimet e Perbashketa do kryhen ne te gjitha rruget e asfaltuara ne administrim te Bashkise Vore. Cdo Inspektim i Perbashket do dokumentohet nga nje Raport Mujor Verifikues i Perbashket.

Inspektimet e perbashketa programohen qe perpara nga Menaxheri i Projektit dhe kryhen nga Kontraktori nepermjet Njesise se tij te Vete-Kontrollit. Qellimi kryesor i inspektimit formal eshte qe te verifikoje informacionin mbi cilesine e punimeve te realizuara dhe Nivelin i Cilesise se Sherbimit te arritur nga Kontraktori dhe te shkruara ne pasqyren mujore per vertetim nga Menaxheri i Projektit.

Menaxheri i Projektit duhet te informoje Kontraktorin per qellimin e tij per te kryer nje Inspektim te Perbashket. Ai duhet te jape njoftim te pakten 24 ore para, duke treguar daten e sakte, oren dhe vendin ku do filloje Inspektimi i Perbashket. Kontraktori eshte i detyruar te jete i pranishem ne ate date, ore dhe vend qe thote Menaxheri i Projektit, duke siguruar mjete fizike te nevojshme per inspektim. Inspektimet e Perbashketa programohen normalisht, por jo domosdoshmerisht te fillojne brenda me pak se 2 (dy) dite mbas paraqitjes nga Kontraktori te paqyres mujore Menaxherit te Projektit; dhe ata duhet normalisht te kryhen brenda nje maksimumi prej 5 (pese) ditesh

Inspektimet e Perbashketa lejojne krahasim te informacionit te dhene nga Kontraktori ne inspektimet e specifikuara dhe provat si edhe ne sistemin e tij te vete-kontrollit me matje aktuale nga Menaxheri i Projektit.

Gjate Inspektimeve te Perbashketa, Menaxheri i Projektit detyrimisht do fuse ne Raportin e Perbashket Mujor Verifikues: (i) rrethanat e pergjitheshme te vendit te vizites, duke perfshire daten, seksionet rrugore te vizituara, personat e pranishem, etj., (ii) cfaredo mospajtimi qe mund te jete dalluar, dhe (iii) kohen e lejuar per ndreqjen e difekteve te dalluara, nese kufijte kohore nuk jane specifikuar sipas zerit aktual te pageses.

Mbi bazen e rezultateve te Inspektimit te Perbashket, Menaxheri i Projektit do te:

- Beje korigjimet/zbritjet ne paqyren mujore te Kontraktuesit (bazuar ne numurin e pikeve te denimeve te dhena), nese verehet ndonje mos-pajtim, dhe ta vertetoje ate per pagese nga Punedhenedisi,
- Te perfshije dhe nese eshte e nevojshme, korigjije Raportin e Perbashket Mujor Verifikuesen (per tu firmosur nga Kontraktori dhe Menaxheri i Projektit se bashku), dhe
- Te dorezoje nje kopje te Pageses Mujore tek Kontraktori.

Inspektimet e Perbashketa do perfshijne gjithashtu edhe vizita kontrolli ne terren te seksioneve, per te cilat jane verifikuar difektet dhe brenda kufijve kohore te caktuara nga Menaxheri i Projektit dhe te specifikuara Raportin e Perbashket Mujor Verifikues.

Qellimi i ketij inspektimi kontrolli eshte qe te kontrolloje nese Kontraktori i ka ndrequr shkaqet e mos-pajtimeve te meparshme, brenda afatit te percaktuar nga Menaxheri i Projektit. Per rrjedhoje keto inspektime kontrolli te perbashketa do te kryhen vecmas, menjehere pas skadimit te kufijve kohore te vena. Nga ana formale keto inspektime te perbashketa mundet vetem te perdoren per kontrollin e shenimeve te meparshme.

Inspektimet e perbashketa do kryhen nga Njesia e Vete-Kontrollit te Kontraktorit ne bashkeveprim me, dhe nen mbikqyrjen e Menaxherit te Projektit. Mjetet fizike qe nevojiten per inspektimin do sigurohen nga Kontraktori.

A.5 DEMET E SHLYERA

A.5.1 HYRJE

Zbritja nga pagesa paraqet nje mase qe duhet zbatuar ne rast se detyrimet e Kontraktuara nuk respektohen nga Kontraktori. Procesi i zbrijes nga pagesa duhet bere me perdorimin e pikeve te denimeve duke perdorur metoden e pershkruar ne poshte.

Piket e denimeve jepen si mase qe duhet te stimuloje Kontraktorin te kryje detyrimet e tij ne nje menyre te organizuar dhe ne kohe dhe te kryje detyren e tij duke arrire standarte te larta edhe pse ato detyra mund te mos duken ne pamje te pare serioze.

Kontraktori do marre pike denimi per mosplotesim detyrimeve te meposhtme.

A.5.2 MIREMBAJTJE RUTINE

Kriteri per zbatimin e pikeve te denimit dhe zhdentimeve:

- a) Mos-pajtim me detyrimet e specifikuara kontraktuale per mirembajtjen rutine qe jane:
 - Nivel sherbimi aktual, nen nivelin minimal te specifikuar te sherbimit;
 - Mos arritja e cilesise se sepcifikuar te punimeve te kryera;

Numeri i Pikeve te denimit per secilin ze ne Specifikimet (Prev Nr.2) do jete:

| Zeri | Rruge |
|---|--------------|
| Mirembajtja e Sistemit te Kullimit (Kanalet, tombinot etj.) | 1 |
| Mirembajtja e Fugave te urave | 1 |
| Mirembajtja e Trupit te rruges | 1 |

| | |
|---|----------|
| Mirmbajtja e trotuareve bordurave dhe pusetave ne rruge | 1 |
| Mirmbajtja e sinjalistikes vertikale dhe ndricimit ne rruge | 1 |
| Mirembajtja e rrugeve nga rreshqitjet | 1 |

- b) Mos-plotesim i kufijve te specifikuar kohore te aprovuar ne Grafiket Kohore te Kontraktuar ose kufijve kohore te vena nga Menaxheri i Projektit per te ndrequr demet

A.5.3 VLEFTA E PIKEVE TE DENIMIT

Piket e Denimit per Kontraten dhe vleren e tyre shoqeruese listohen ne tabelen me poshte.

| Numeri i Pikeve | | Vlefte e nje pike ne Lek |
|-----------------|------|--------------------------|
| Nga | ne | |
| 1 | 50 | 10,000.00 |
| 51 | 75 | 25,000.00 |
| 76 | 125 | 50,000.00 |
| 126 | 175 | 75,000.00 |
| 176 | 200 | 100,000.00 |
| | >200 | 125,000.00 |

Nese gjate Kontrates Kontraktori merr 175 pike denimi, Kontraktori nuk do lejohet per nje periudhe dy-vjecare te garoje per ndonje kontrate tjeter me baze efektivitetin.

Nese gjate Kontrates, Kontraktori denohet me mbi **100 pike**, Punedhenesi e ka te drejte ta mbylle Kontraten.

Piket e Denimit mblidhen dita 1 e Kontrates.

A.6 VEPRIMET ME DIFEKTET

Gjate zbatimit te Kontrates, disa difekte mund te kapen ne lidhje me cka vijon:

- Cilesia e materialeve te perdorura,
- Cilesia e puneve te kryera,
- Arritja e nivelit te kerkuar te sherbimit.

Eliminimi i cfaredo difekti te permundur do behet ne ngarkim te Kontraktorit brenda kufirit kohor te specifikuar ose, nese nuk ka specifikim te tille, brenda afatit te percaktuar nga Menaxheri i Projektit. Nese brenda kufirit kohor te specifikuar Kontraktori nuk i eliminon difektet sipas caktimit gjate Insektimit te Perbashket, kjo do merret si mos-pajtim dhe Kontraktori do marre pike denimi ne pajtim me kushtet e dhena ne Kapitullin A.5, Demet e Shlyera.

A.7 RIVENDOSJA E BURIMEVE TE PAHARXHUARA

Nese burimet financiare te vena ne buxhet per implementimin e Kontrates per ndonje ze nuk jane harxhuar dhe punimet e planifikuara jane kryer, Menaxheri i Projektit mund te vendose te rivendose burimet e tepruara ne ndonje ze tjeter brenda mirembajtjes per te cilin ai e vlereson qe ka nevojte.

A.8 DETYRAT ADMINISTRATIVE TE KONTRAKTORIT

A.8.1 INSPEKTIMET RRUGORE TE ZAKONSHME

Kontraktori eshte i detyruar te kryeje inspektime ditore, nga e hena ne te djele, duke perfshire dhe ditet e festave duke perfshire dite-pushimet, ne rruget brenda Kontrates.

Pas inspektimit Kontraktori do pergatise nje raport mbi seksionin rrugor te inspektuar dhe ky raport do informoje mbi cka vijon:

- ▶ Liste e informacionit paresor:
 - Data e inspektimit te zakonshem,
 - Emri dhe numri identifikues i seksionit,
 - Kush po e realizon,
 - Shenime mbi mangesite sipas seksionit dhe dhe zerit,
 - Niveli i arritur i sherbimit (mbi/nen /nivel minimal),
 - Vellimi i vleresuar.

- ▶ Liste e informacionit dytesor:
 - Punime te Pa-autorizuara ne zonen e mbrojtur te rruges (e percaktuar nga ligjet ne fuqi per Ndertimet dhe Rruget):
 - ♦ Rruge me dalje te paligjeshme,
 - ♦ Rimbushje e paligjeshme e kanaleve,
 - ♦ Punime infrastrukurore te paligjeshme,
 - ♦ Shkarkime materialesh (plehra, mbeturina, rrenoja, drunj, etj.);
 - Vjedhje, demtime, dhe vandalizma ndaj pajisjeve, shenjave rrugore, etj.;
 - Aksidente rrugore;
 - Aksidente rrugore te makinave me mallra te rrezikshme (pergjegjesia e Punedhenesit percaktohet me Ligj dhe i delegohet Kontraktorit);
 - Rreshqitje toke dhe shkembenjsh.

Ne te tilla raste Kontraktori do te sipermarre masat e nevojshme per te manexhuar trafikun dhe per te informuar Menaxherin e Projektit per ngjarjen, menjehere pas zbulimit apo njoftimit te ngjarjes.

Nese demi eshte i vogel aq sa trafiku mund te manexhohet sigurt nepermjet korsise tjeter, nje korsi trafiku do te mbyllet.

Nese demi eshte me i madh aq sa trafiku nuk mund te perballohet ne ate pjese te ruges, rruga do mbyllet e gjitha.

Kontraktori eshte pergjegjes per te siguruar vendin e ngjarjes me shenjat e duhura rrugore, sinjalet dhe pajisjet, dhe ne rastin e nderprerjes se trafikut ta manexhoje trafikun ne rruge te tjera.

Nese punimet ne riparimin e rreshqitjeve te dherave apo gureve kerkojne nderhyrje domethenese, qe nuk mbulohen nga Kontrata per mirembajtje te rregullt, bazuar ne raportin e Kontraktorit, Menaxheri i Projektit mund te kerkoje mbeshtetje nga Bashkia.

Kontraktori do e pajise Menaxherin e Projektit me Raportet mbi inspektimet e zakonshme ne nje kopje, nje te Hene po e nje jo, te cdo muaji, ne oren 12.

Ne rastin e punimeve te jashteligjshme Ne Rezerven Rrugore (zona e mbrojtur rrugore), vjedhje, demtime te pajisjeve dhe shenjave rrugore, vandalizem, aksidente rrugore dhe rreshqitje te dherave apo gureve duke shkaktuar mbyllje (te pjeseshme) te ruges, Kontraktori do pajise Menaxherine Projektit me nje raport shtese menjehere pas inspektimit te seksionit rrugor.

B. PUNIME RUTINE MIREMBAJTJEJE RRUGE

B.1 SPECIFIKIM I PUNIMEVE SIPAS ZERAVE

Preventivi – Nr.1

Zeri 1.1 :Vendosja e kontraktorit ne kantier

Pershkrim

Ky perfshin:

- Vendosja brenda nje jave, e nje kampi ne afersi te kantierit, me te gjitha faciletetet per pritje.
- Ruajtja, ndricimi, kontrolli i trafikut, duke perfshire dhe shenjat e trafikut, si tregohet ne Planin e Manaxhimit te Trafikut dhe ruajtja e punimeve gjate gjithe kohes.
- Vendosja ne pritje e nje stafi te kualifikuar te kontraktorit dhe te facileteteve komunikuese,
- Veshjet e shiut dhe xhaketat reflektuese per te gjithe punetoret.

- Prezenca e perhershme (nga hena ne te premte perfshire dhe ditet e festave), gjate gjithe periudhes se kontrates, e te pakten 1 (nje) puntori per cdo 3 (tre) kilometer, por numri total i punetoreve duhet te jete te pakten tre per te realizuar detyrimet e pergjithshme te mirembajtjes.
- Prezenca e perhershme per ditet e shtuna dhe te diela te jete te pakten 50% e asaj te kerkuar ne ditet e tjera .
- Sigurimi dhe garancite.

Pagesa

Ky ze nuk do te paguhet pasi nuk ka preventive (n.q.s. do te jete)do te shprehet 0 (zero), dhe te gjitha shepnzimet per kete ze punimi do te parashikohen dhe perballohen nga kontraktori.

Kantieri do te inspektohet disa here ne muaj nga Supervizori dhe Perfaqesuesit e punedhenesit. Ne rast se do te gjendet numri i punetore me i vogel se ai i kerkuar ne kontrate, kontraktori do ti behet nje zbritje ne vlere. Zbritja do te llogaritet ne baze te formules se meposhtme duke supozuar qe ky ka qene numri i punetoreve per nje jave.

(nr. punetoreve aktual / nr. Punetoreve te kerkuar)% x (pagesen javore)

ku: pagesa javore = pagesa mujore / 4

Preventivi - Nr. 2

Zeri 2.1 *Pastrimi dhe lirimi i kunetave, kanaleve te hapura, K.U.Z .dhe K.U.B.*

Pershkrim

Ky ze do mbuloje pastrime rutine te kunetave te ceketa, kanaleve te hapura, K.U.Z .dhe K.U.B. nga depozitimet dhe materialet e ndryshme hedhurine; duke perfshire mbledhjen, ngarkimin dhe transportimin e materialit te prishur jashte rruges. Kontraktori do kryeje inspektime rutine dhe mbi bazen e gjetjeve aktuale dhe do sipermarre aktivitetet e pershtateshme.

Ne rast se drenimet do te jene plotesisht te mbuluara dhe nuk arrihet te kuptohet dimensiononi, germimi do behet aq i thelle dhe i gjere sa te lejoje rrjedhjen e ujit, qe mund te mblidhet nga nje stuhi e forte, dhe te kulloje karrexhiata.

Kerkesa

Kanalet dhe tubacionet dhe pusetat do pastrohen per te lejuar rrjedhjen e lire te ujit. Fundi i kanalit do pritret deri ne thellesine origjinale me nje tolerance prej ± 5 cm te matur me nje shufer 2 meter te gjate aty ky nuk lejohet mbajtja e ujit. Faqja e brendshme anesore do pritret deri ne 1:3 me nje maksimum pjerresie 1:2.

| | |
|--------------------------|--|
| Niveli fillestar: | Niveli fillestar eshte arritur kur rrjedha e ujit eshte kufizuar dhe ka peggje me te thella se 5 cm. |
| Niveli minimal: | Niveli minimal i sherbimit arrihet kur ka peggje me te thella se 10 cm dhe thellesia minimale nga siperfaqja deri ne fund te |

| | |
|--|--------------------------------|
| | kullimit eshte me pak se 50cm. |
|--|--------------------------------|

Pagesa

Ky ze do paguhet me muaj sipas preventivit.

Zeri 2.3 Pastrimi dhe lirim Tombinove rrethore dhe katrore

Pershkrim

Ky ze do mbuloje pastrimin dhe lirimin e depozitimeve te inerteve, llumrave, etj. dhe pleherave te tjera nga tombinot rrethore dhe katrore si dhe hyrjet dhe daljet; duke i ngarkuar dhe transportuar jashte rruges.

Kerkesa

Tombinot rrethore do pastrohen aq sa te lejojne kullim efektiv te ujit nepermjet trupit te rruges. Te pakten $\frac{3}{4}$ e diametrit te tubit do te jete i lire nga depozitimet duke lejuar rrjedhjen e lire te ujit.

| | |
|--------------------------|--|
| Niveli fillestar: | Depozitat qe kalojne 15% te dimetrit te tombinos. Tombino eshte ne gjendje pune. |
| Niveli minimal: | Me shume se 1/4 e diametrit te cilindrit eshte e mbushur me depozita. Funkzioni i tombinos eshte i pakesuar. |

Tombinot kuti do pastrohen aq sa te lejojne kullim efektiv te ujit nepermjet trupit te rruges.

| | |
|--------------------------|---|
| Niveli fillestar: | Depozita mesatare kalon 10cm ne tombino. |
| Niveli minimal: | Lartesia e depozites ne tombino mbi 20cm. |

Pagesa

Ky ze do paguhet me muaj.

Zeri 2.7 Nivelim me greider i bankinave dhe mbushjeve

Pershkrim

Ky ze perfshine eliminimin gropave dhe valezimeve ne bankina (ne siperfaqet e lira te bankinave, rreth parmave fleksibel, shenjave te trafikut, paisjeve dhe paisjeve te ngjashme ne bankina) duke vendosur material shtese, transportin e materialit jashte rruges. Per riparimin e gropave duke perdorur material jo-koheziv dhe te ngjishet sa te jete e nevojshme. Ky ze perfshin dhe punimet e mirembajtjes se mbushjeve.

Kerkesa

Bankinat duhet te jene ne gjendje qe ne cdo moment te shkarkojne ujin e shiut nga rruqa. Bankinat duhet te kene nje renie 4-8% ne lidhje me pjerresine e mbushjeve. Mbajtja e ujit ne siperfaqen e mbushjeve nuk eshte e lejuar. Kapaciteti mbajtjes i

bankinave duhet te jete i tille qe te perpalloje presionin makinave te renda pa lejuar nje deformim te perhershem. Devijimet e valezimeve gjatesore do te maten me nje mastar me gjatesi limit 2m. Ana e bankines pergjate asfaltit nuk duhet te kaloje mbi asfalt. Materiali i perdorur duhet te jete ne perputhje me specifikimet ne lidhje me cilesine. Siperfaqet e vogla te deformuara ne mbushje do te germohen dhe rimbushen per rastet kur keto demtime vijne nga erozioni apo ndonje shkak tjetër. Nivelimi i siperfaqeve te pjerrta duhet te realizohet ne menyre te tille qe shkalla e pjerrtesise te jete e perafert me ate te mbushjes origjinale.

| | |
|--------------------------|---|
| Niveli fillestar: | Devijimi pergjate asfaltit te jete jo me shume se 5cm. devijimet e valezimeve gjatesore jo me shume se 2cm. |
| Niveli minimal: | Devijimi pergjate asfaltit te jete jo me shume se 8cm. devijimet e valezimeve gjatesore jo me shume se 4cm. |

Pagesa

Ky ze do paguhet me muaj.

Zeri 2.8 Prerja, Shkulja dhe Pastrimi i Bimesise nga anes rruges.

Pershkrim

Ky ze do mbuloje pastrimin e bimesise dhe prerjen, shkuljen e shkurreve, pemeve, dhe degeve nga bankinat, bankinat ose prerjeve, perreth shenjave rrugore, shenjave te drejtimit, postave shenuese dhe pajisjeve te ngjashme brenda zones se rruges; duke i stivuar, mbledhur, ngarkuar, dhe transportuar materialin, jashte Zones se Rruges.

Kerkesa

| Kerkesa Cilesie | | Kategorite e Mirembajtjes se Rruges | |
|---|------------------|-------------------------------------|--------------|
| | | Rruge Kombetare | Rruge Rurale |
| Lartesia e Bimesise ne bankina (cm) | Niveli fillestar | 20 | 20 |
| | Niveli minimal | 40 | 40 |
| Lartesia e bimesise ne zona te tjera brenda rruges (cm) | Niveli fillestar | 30 | 50 |
| | Niveli minimal | 50 | 50 |

Lartesia e bimesise ne bankina do matet nga niveli i shtreses se asfaltit me te afert. Lartesi e bimesise ne zonat e tjera te gjelbera ne siperfaqet e tjera te gjelbera do matet nga niveli i dheut ekzistues.

Shkurret e prera dhe te shkulura, pemet dhe deget do hiqen brenda nje periudhe jo me te gjate se shtate (7) dite nga data e prerjes. Lartesia maksimale e prerjes eshte 10 cm e matur nga niveli i dheut perbri.

Pagesa

Ky ze do paguhet me muaj.

Zeri2.9 Heqja e gurishteve, gureve te rene, dhe rreshqitjeve te dherave

Pershkrim

Ky ze do mbuloje punimet per sigurimin e nje kalimi te sigurt te trafikut, heqjen e gurishteve, dhe gureve te rene dhe dherave te rene, duke i ngarkuar ne nje kamion dhe hedhur pertej rezeves rrugore.

Kerkesat

Pjesa e rruges ku kane ndodhur rreshqitjet do shenohet jo me vone se 2 ore mbas marrjes se informacionit mbi ngjarjen. Gjate heqjes se materialit, profili rrugor nuk duhet te priset, as edhe te demtohen pajisjet e rruges, perndryshe Kontraktori do ngarkohet me riparimin e tyre.

Pagesa

Ky ze do paguhet mbi baze mujore.

PREVENTIVI – PREVENTIVI NO. 3

Zeri 3.1 Sigurim, shtrim dhe ngjeshje ne gropat tashme te pergatitura e asfaltimit me penetrim ose asfaltit te prodhuar per kete qellim ne fabrika te vecanta

Pershkrim

Ky pershkrim aplikohet per pergatitjen e gropave me forme dhe sprucimin e tyre me prajmer dhe sigurimin dhe shtrimin e asfaltimit me penetrim ose asfaltit te prodhuar ne fabrike te vecante.

Kerkesa

Kerkesat perfshijne prerjen e gropave. Gropat duhet te pritet sipas nje figure te rregullt gjeometrike (katrore apo drejtkendeshe) me faqe paralele me aksin e rruges ose me anet e shtreses ekzistuese. Faqet duhet te jene te prera vertikalisht. Pjeset e paqendrueshme duhet te hiqen dhe gropa duhet te pastrohhet me ajer me presion te larte para se sprucohen me prajmer dhe sigurimin dhe shtrimin e asfaltimit me penetrim ose asfaltit te prodhuar ne fabrike te vecante.

| | |
|--------------------------|--|
| Niveli fillestar: | Gropat nuk lejohen dhe duhet te riparohen brenda 5 diteve nga zbulimi i tyre. |
| Niveli minimal: | Niveli minimal i sherbimit arrihet nqs kemi nje siperfaqe te vetme te demtuar prej 0.2 m2 ose nje maksimum total |

| | |
|--|--|
| | siperfaqeje te demtuara per nje 1 km arrin 2m2 |
|--|--|

Ne rastet kur moti nuk lejon mbushjen e gropave me asfalt menjehere, atehere kontraktori do ti mbushe ato me material te perkohshem, duke patur parasysh qe rruga duhet te jete pa gropa. Gropat e mbushura ne kete menyre do te rimbushen si duhet sapo te jete e mundur nga moti.

Pagesa

Ky ze do paguhet me muaj.

Zeri 3.2: Sigurim dhe aplikim i perpunimit siperfaqesor me Dy Duar ne te nxehte.

Pershkrim

Ky pershkrim perfshin pergatitjen e siperfaqes se demtuar, sprucimin e tyre me prajmer dhe sigurimin dhe shtrimin e perpunimit siperfaqesor me Dy Duar ne te nxehte ne zonat e cara me granil.

Kerkesa

Siperfaqet e demtuara duhet te pastrohen me ajer me presion te larte para se sprucohen me prajmer sigurimin dhe shtrimin e perpunimit siperfaqesor me Dy Duar ne te nxehte.

| | |
|--------------------------|---|
| Niveli fillestar: | Gropat nuk lejohen dhe duhet te riparohen brenda 5 diteve nga zbulimi i tyre. |
| Niveli minimal: | Niveli minimal i sherbimit arrihet nqs kemi nje siperfaqe te vetme te demtuar prej 0.2 m2 ose nje maksimum total siperfaqeje te demtuara per nje 1 km arrin 2m2 |

Pagesa

Ky ze do paguhet me meter katror (m2).

Zeri 3.4 Sigurim dhe shtrim dhe ngjeshje ne gropat tashme te pergatitura e shtreses se makadamit per te krijuar shtresen baze te rruges.

Pershkrim

Ky pershkrim aplikohet per pergatitjen e gropave, sigurimin, shtrimin dhe ngjeshjen e Makadamit per te formuar shtresen baze te rruges.

Kerkesa

Kerkesat perfshijne prerjen e gropave. Gropat duhet te pritet sipas nje figure te rregullt gjeometrike (katrore apo drejtkendeshe) me faqe paralele me aksin e rruges ose me anet e shtreses ekzistuese. Faqet duhet te jene te prera vertikalisht. Pjeset e paqendrueshme duhet te hiqen dhe gropa duhet te pastrohet me ajer me presion te larte para se te lagen si dhe te behet shtrimi dhe ngjeshja e makadamit te aprovuar.

| | |
|--------------------------|--|
| Niveli fillestar: | Gropat nuk lejohen dhe duhet te riparohen brenda 5 diteve nga zbulimi i tyre. |
| Niveli minimal: | Niveli minimal i sherbimit arrihet nqs kemi nje siperfaqe te vetme te demtuar prej 0.7 m2 ose nje maksimum total siperfaqeje te demtuara per nje 1 km arrin 50m2 |

Pagesa

Ky ze do paguhet me muaj.

Zeri 3.5 *Sigurim, shtrim dhe ngjeshje ne gropat tashme te pergatitura e zhavorrit/granilit per riparim rruges te pashtruara dhe bankine .*

Pershkrim

Ky pershkrim aplikohet per pergatitjen e gropave, sigurimin, shtrimin dhe ngjeshjen e zhavorrit/granilit per te riparuar rruget e pashtruara dhe bankinat..

Kerkesa

Kerkesat perfshijne prerjen e gropave. Gropat duhet te pritet sipas nje figure te rregullt gjeometrike (katrore apo drejtkendeshe) me faqe paralele me aksin e rruges ose me anet e shtreses ekzistuese. Faqet duhet te jene te prera vertikalisht. Pjeset e paqendrueshme duhet te hiqen dhe gropa duhet te pastrohet me ajer me presion te larte te lagen para se behet shtrimi dhe ngjeshja me material zhavorr/granil.

| | |
|--------------------------|--|
| Niveli fillestar: | Gropat nuk lejohen dhe duhet te riparohen brenda 5 diteve nga zbulimi i tyre. |
| Niveli minimal: | Niveli minimal i sherbimit arrihet nqs kemi nje siperfaqe te vetme te demtuar prej 1.0 m2 ose nje maksimum total siperfaqeje te demtuara per nje 1 km arrin 60m2 |

Pagesa

Ky ze do paguhet me muaj.

Zeri 3.8 *Furnizim dhe lryje me boje te shenjave rrugore dhe te strukturave.*

Pershkrim

Ky pershkrim aplikohet per furnizim dhe lryje me boje te bardhe te shenjave rrugere dhe te strukturave.

Kerkesa

Kerkesat jane per Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetorese, furnizimin dhe ngritjen e materialeve te nevojshme si dhe te lryjeve dhe mikro-sferave per finalizimin e shenjave por edhe per procedurat parashenjuese. Transportimin perfshire

mjetet e transportit dhe trajtimin e te gjitha makinerive te nevojshme si dhe pastrimin dhe sinjalizimin e rruges gjate punes dhe testimin.

Pagesa

Ky ze do paguhet me m2 (sic shprehet ne preventiv).

Zeri 3.9 Riparim trotuare betoni ose me pllaka betoni.

Pershkrim

Ky pershkrim aplikohet per gropat ne shtresat e betonit apo carjet ne betonet e trotuareve, ne perputhje me Specifikimet teknike, Planin e Manxhimit te Trafikut dhe kerkesat e Manaxherit te Projektit. Ne rastet e shtrimit te trotuareve me pllaka betoni parashikohet zevendesi i pllakave te deformuara te thyera apo te munguara ne perputhje me Specifikimet teknike, Planin e Manxhimit te Trafikut dhe kerkesat e Manaxherit te Projektit

Kerkesa

Kerkesat jane per Furnzimin e materialeve, makinerive dhe punetore, furnizimin dhe ngritjen e materialeve te nevojshme per realizimin e zerit te punimeve,. Transportimin perfshire mjetet e transportit dhe trajtimin e te gjitha makinerive te nevojshme si dhe pastrimin dhe sinjalizimin e rruges gjate punes dhe testimin.

Pagesa

Ky ze do paguhet me m2 (sic shprehet ne preventiv).

Zeri 3.10 Riparim bordura betoni.

Pershkrim

Ky pershkrim aplikohet per bordurat e trotuareve te thyera apo te demtuara, ne perputhje me Specifikimet teknike, Planin e Manxhimit te Trafikut dhe kerkesat e Manaxherit te Projektit.

Kerkesa

Kerkesat jane per Furnzimin e materialeve, makinerive dhe punetore, furnizimin dhe ngritjen e materialeve te nevojshme per realizimin e zerit te punimeve,. Transportimin perfshire mjetet e transportit dhe trajtimin e te gjitha makinerive te nevojshme si dhe pastrimin dhe sinjalizimin e rruges gjate punes dhe testimin.

Pagesa

Ky ze do paguhet me ml (sic shprehet ne preventiv).

Zeri 3.11 *Riparim puseta KUZ dhe KUB si dhe zevendesimi i kapakeve te pusetave*

Pershkrim

Ky pershkrim aplikohet per pusetat dhe kapaket e prishur apo te demtuar, ne perputhje me Specifikimet teknike, Planin e Manxhimit te Trafikut dhe kerkesat e Manaxherit te Projektit.

Kerkesa

Kerkesat jane per Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetorise, furnizimin dhe ngritjen e materialeve te nevojshme per realizimin e zerit te punimeve. Transportimin perfshire mjetet e transportit dhe trajtimin e te gjitha makinerive te nevojshme si dhe pastrimin dhe sinjalizimin e rruges gjate punes dhe testimin.

Pagesa

Ky ze do paguhet sic shprehet ne preventiv.

Zeri 3.12 *Zevendesimi i sinjaleve vertikale komplet (tabela, boshti, aksesore, etj).*

Pershkrim

Ky pershkrim aplikohet per zevendesimin i sinjaleve vertikale komplet (tabela, boshti, aksesore, etj), ne perputhje me Specifikimet teknike, Planin e Manxhimit te Trafikut dhe kerkesat e Manaxherit te Projektit.

Kerkesa

Kerkesat jane per furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetorise; furnizimin dhe ngritjen e materialeve te nevojshme per lysterjen e gureve te kilometrazhit, shenjave te drejtimit dhe te trafikut ne perputhje me Planin e Manxhimit te Trafikut; transportimin perfshire mjetet e transportit dhe trajtimin e te gjitha makinerive dhe materialeve te nevojshme dhe testimin.

Pagesa

Ky ze do paguhet sic shprehet ne preventiv.

Zeri 3.13 *Riparim dhe zevendesim i shtyllave elektrike te ndricimit dhe te llampave ne rruge*

Pershkrim

Ky pershkrim aplikohet per Riparimin dhe zevendesimin e shtyllave elektrike te ndricimit dhe te llampave ne rruge, ne perputhje me Specifikimet teknike, Planin e Manxhimit te Trafikut dhe kerkesat e Manaxherit te Projektit.

Kerkesa

Kerkesat jane per furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetorise; furnizimin dhe ngritjen e materialeve te nevojshme per lyerjen e gureve te kilometrazhit, shenjave te drejtimit dhe te trafikut ne perputhje me Planin e Menaxhimit te Trafikut; transportimin perfshire mjetet e transportit dhe trajtimin e te gjitha makinerive dhe materialeve te nevojshme dhe testimin.

Pagesa

Ky ze do paguhet sic shprehet ne preventiv.

Zeri 3.14

Sigurimi dhe zevendesimi i mbrojteseve metalike (guardrail)

Pershkrim

Ky pershkrim aplikohet per heqjen dhe zevendesimin e elemeteve metalike te demtuar ne perputhje me specifikimet teknike dhe tipin e mbrojteseve metalike.

Kerkesa

Kerkesat jane per furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetorise; montimin dhe c'montimin e paisjeve dhe asesoreve metalik; furnizimin dhe ngritjen e materialeve per vendosjen dhe fiksimin e elementeve metalike; marrjen e kampioneve dhe testimin; matjen topografike dhe nivelimin; transportimin perfshire mjetet e transportit dhe trajtimin e te gjitha makinerive dhe materialeve te nevojshme dhe testimin.

Pagesa

Ky ze do paguhet me meter linear (ml).

Zeri 3.15 Sigurimi dhe lyerja me ngjyra te pershtateshme te gureve te kilometrazhit, tabelave drejtuese dhe shenjave te trafikut. Perfshi te gjitha figurat dhe germat.

Pershkrim

Ky pershkrim aplikohet per Sigurimin dhe lyerjen me ngjyra te pershtateshme te gureve te kilometrazhit, tabelave drejtuese dhe shenjave te trafikut. Perfshi te gjitha figurat dhe germat.

Kerkesa

Kerkesat jane per Furnzimin e materialeve, makinerive dhe punetorise, furnizimin dhe ngritjen e materialeve te nevojshme si dhe te lyerjeve dhe mikro-sferave per finalizimin e shenjave por edhe per procedurat parashenjuese. Transportimin perfshire mjetet e transportit dhe trajtimin e te gjitha makinerive te nevojshme si dhe pastrimin dhe sinjalizimin e rruges gjate punes dhe testimin.

Pagesa

Ky ze do paguhet me cope (sic shprehet ne preventiv).

B.2 AFATET E PUNIMEVE SIPAS ZERAVE TE PUNES

| Zera te Mirembjtjes Rutine te Rrugeve | | Kategorite e Mirembjtjes se Rrugeve |
|---------------------------------------|---|-------------------------------------|
| Zeri Nr | Emri i Zerit | Rruget te asfaltuara |
| 2. | Prev Nr. 2 | |
| 2.1 | Mirembajtje e drenimeve anesore ose kanaleve | 10 |
| 2.3 | Pastrim i Tombinove Rrethore dhe katrore | 20 |
| 2.7 | Nivelimi i bankinave dhe mbushjeve | 20 |
| 2.8 | Prerja, shkulja dhe pastrimi i bimesise anash rruges | 20 |
| 2.9 | Heqja e gurishteve, shkembinjve te rene dhe dherave te rreshqitur | 1 |
| 3. | Prev Nr. 3 | |
| 3.1 | Mbushja e gropave me asfalt me penetrim ose asfaltit te prodhuar | 3 |
| 3.2 | Perpunimi siperfaqesor me Dy Duar ne te nxehte | 5 |
| 3.3 | Mbushje gropash me cakell makadam | |
| 3.4 | Sigurimi, shtrimi ne gropa dhe ngjeshja e makadamit te lidhur me uje te aprovuar, per te krijuar shtresen baze te rruges. | 5 |
| 3.5 | Sigurimi, shtrimi ne gropa dhe ngjeshja e zhavorrit/granilit, per te riparuar karrexhaten dhe bankinat. | 5 |
| 3.6 | Kryerja e riparimeve ne strukturat prej tulle ose guri me | 30 |

| | | |
|------|--|----|
| | llac cemento 1:3 | |
| 3.7 | Kryerja e riparimeve ne strukturat e betonit ne rruge e bankina | 30 |
| 3.8 | Sigurimi dhe lysterja me boje te bardhe te aprovuar te shenjave dhe strukturave rrugore | 30 |
| 3.9 | Riparim trotuare betoni/ pllaka betoni | 30 |
| 3.10 | Riparim bordura betoni | 30 |
| 3.11 | Riparim puseta betoni + zevendesim kapake pusetash | 30 |
| 3.12 | Riparimi/zevendesimi i shtyllave elektrike dhe llampave ne rruge | 30 |
| 3.13 | Riparimi/zevendesimi i sinjalistikes vertikale (tabela +aksesore) | 30 |
| 3.14 | Sigurimi dhe zevendesimi i mbrojteseve metalike (guardrail) | 30 |
| 3.15 | Sigurimi dhe lysterja me ngjyra te pershtateshme te gureve te kilometrazhit, tabelave drejtuese dhe shenjave te trafikut. Perfshi te gjitha figurat dhe geramat. | 30 |

Kufijte ne tabelle jane shprehur ne dite kalendarike. Kufijte e treguar per kryerjen e punimeve paraqesin datat per kushtet minimale te planifikuara, qe do te thote kohen me te shkurter ne te cilen Kontraktori do plotesoje punimet. Ne kushte te zakonshme Menaxheri i Projektit nuk do te urdheroje punime per tu kryer ne me pak kohe seç specifikohet. Per arsye objektive Menaxheri i Projektit mund te shtyje daten e plotesimit ne krahasim me kufirin minimal te dhene, ne te cilin rast kufiri i shtyre nuk duhet te jete me i gjate se dyfishi i vleres se specifikuar per secilin ze.

TABELA E PERMBAJTJES

1100 KERKESA TE PERGJITHSHME

1200 SPECIFIKIMET TEKNIKE

1300 METODA E PAGESES DHE PERSHKRIMI



PERMBAJTJA

| | |
|--|-------|
| 1101 HAPESIRA E PUNIMEVE | |
| 1102 DETYRIMET E KONTAKTORIT | |
| 1102.1 Dokumenta per qe duhet te paraqiten nga kontraktori | |
| 1102.2 Punimet e perkohshme | |
| 1102.3 Sturkturat ekzistuese dhe sherbimet nentokesore..... | |
| 1102.4 Trajtimi i ujrave..... | |
| 1102.5 Dispozita te vecanta per dimrin..... | |
| 1102.6 Kontraktore te tjere..... | |
| 1102.7 Vizatimet e ‘faktit’ | |
| 1103 ZOTERIMI DHE PERDORIMI I OBJEKTIT | |
| 1104 MIRATIMET NGA MENAXHERI I PROJEKTIT | |
| 1105 HYRJA NE PRONE | |
| 1106 SHERBIME | |
| 1107 SIGURIMI I SHERBIMIT 24 ORE I KONTRAKTORIT ME PERSONELIN KRYESORE | |
| 1108 NGRITJA E KANTIERIT NE AFERSI TE OBJEKTIT | |
| 1109 RUAJTJA E MJEDISIT | |
| 1110 PROCEDURAT E STUDIMEVE, TESTIMEVE DHE MATJEVE | |
| 1111 SISTEMI I GARANTIMIT TE CILESISE PER PUNIMET E INXHINIERISE CIVILE | |
| 1112 SISTEMI I MENAXHIMIT TE TRAFIKUT | |
| 1113 PUNIME TE PAPANASHIKUARA | |

1100 KERKESA TE PERGJITHSHME

1101 HAPESIRA E PUNIMEVE

Specifikimet teknike aplikohen per Punimet e mirembajtjes.

Punimet jane bazuar ne Projektet e pergatitura ne faza te ndryshme, si Dokumentacioni i Tenderit, Ofertat, Kontratat dhe Specifikimet.

Cdo Kontrate, nenkontrate, udhezim, miratim etj qe behet apo leshohet gjate periudhes ndertimore te Punimeve, duhet te pergatitet sipas kerkeses se Menaxherit te Projektit.

1102 DETYRIMET E KONTRAKTORIT

Vizatimet ne Dokumentat e Tenderit jane konsideruar te mjaftueshme per te ilustruar pozicionin e punimeve te kerkuara nga Kontrata dhe do te bejne te mundur qe Tenderuesi te jape Oferte te sakte.

Kontraktori do te tenderoje per te gjitha punimet, sipas Nen-Klauzoles 1.1, Seksioni 2, Kushtet e Kontrates.

1102.1 Dokumenta qe duhet te paraqiten nga Kontraktori.

Kontraktori duhet te paraqese tek Menaxheri i Projektit dokumentat e meposhtem.

- Programin e Punimeve sipas Klauzoles perkatese, Kushtet e Kontrates qe paraqet fazat e te gjitha punimeve, ne menyre te vecante parashikimet e kontraktorit ne lidhje me punimet sezonale dhe ne cilat aktivitete kontraktori ka nder mend te fokusohet gjate cdo muaji, ne varesi te motit;
 - Listen e Fuqise Punetore dhe te Makinerive qe jane ne kantier [shih piken (i) me poshte];
 - Grafikon e punimeve mujore (GPM) [shih piken (ii) me poshte];
 - Planin e pergjithshem te manaxhimit te trafikut [shih Specifikimet, Klauzola 1112]; dhe
 - Planet mujore te manaxhimit te trafikut (PMT) [shih Specifikimet Zeri 1112].
- (i) Kontraktori do ti dorezoje Manaxherit te Projektit ne fund te cdo muaji kalendarik, ose ne ndonje kohe tjeter si mund te bihet dakort, nje program te detajuar mbi makinerite dhe puntorine ne kantier, te ndara ne kategori, dhe qe te tregojte se cilat jane makinerite dhe puntoret e Kontraktorit dhe cilet te nen-kontraktorit nese ka.
- (ii) Kontraktori do pergatise, per cdo muaj “Programin mujor te punimeve” bazuar ne inspektimin e te gjithe ruges. Inspektimi i kontraktorit behet per te identifikuar ku eshte e nevojshme te nderhyet per pastrim, riparim, zevendesim ne perputhje me “nivelin e kerkuar” dhe “nivelin minimal” te sherbimeve te kerkuara te Specifikimet, Seksioni B1 “Specifikimet e punimeve per zerat”. Programi mujor i puneve i pergatitur do ti dorezohet

Manaxherit te Projektit, ose perfaqesuesve te tij, per aprovim te pakten 7 (shtate) dite para fundit te muajit. Manaxheri i Projektit, ose perfaqesuesi i tij, do te beje aprovimin e planit mujor te puneve ose ne mirekuptim me kontraktorin do te beje modifikimin e tij para fundit te muajit.

1102.2 Punimet e perkoheshme

Kontraktori do te projektoje, organizoje, vendose dhe largoje me shpenzimet e tij te gjitha punimet e perkoheshme te nevojshme. Punimet e perkoheshme perfshijne ndryshimin e kushteve te rruges kur e sheh te nevojshme. Te gjitha punimet e perkoheshme do te jene sipas kerkeses se Menaxherit te Projektit, por kjo nuk perjashton pergjegjesine e kontraktorit per projektimin dhe mjaftueshmerine e tyre. Kontraktori duhet te marre miratimin e Ministrive, pronareve te sherbimeve, autoriteteve lokale dhe paleve te tjera te treta per projektimin e punimeve te perkoheshme kur dhe ku kerkohet.

Kontraktori do te jete i pergjegjshem per marrjen e te gjitha miratimeve dhe lejeve per organizimin e shfrytezimit te te gjithe tokes se nevojshme per cdo lloj punimi te perkohshem sic jane rruget hyrese, devijimet, bazat e prodhimit, ambientet e objektit, zonat per ruajtjen / mbajtjen e materialeve dhe makinerive, ambientet laboratorike dhe te tjera. Kontraktori duhet te ktheje ne gjendjen e meparshme ose ne ate te kerkuar nga Menaxheri i Projektit te gjitha zonat e prekura nga punimet e perkohshme.

Kontraktori duhet te projektoje dhe ndertoje cdo lloje devijimi te perkohshem rruge dhe do te jete i pergjegjshem per marrjen e miratimeve dhe lejeve nga te gjithe pronaret e tokave dhe organizatat e tjera perkatese te prekura nga keto punime te perkohshme.

Devijimet e perkohshme te rrugeve duhet te projektohen dhe ndertohen duke perdorur materiale dhe punetori te tillla te cilat nuk do te sjellin cedime, valezime apo deformime te siperfaqes se devijimit. Devijimet duhet te profilohen me nje shtrese konsumuese te qendrueshme dhe pa valezime.

Projekti i devijimit duhet te paraqitet, nepermjet Menaxherit te Projektit, tek Punedhensesi per miratim teknik. Kontraktori duhet te paraqese detajet e skices se tij edhe tek pronaret e tokes, autoritetet e lumit, etj.

Sebashku me projektin e devijimit, Kontraktori duhet t'i paraqese Menaxherit te Projektit propozimet e tij per menaxhimin e trafikut dhe te sigurise gjate kohes qe perdoret devijimi, ne perputhje me Kaluzolen 1112.

Me perfundimin e seksionit perkates te Punimeve ku jane ndertuar punime te perkohshme, Kontraktori duhet t'i largoje ato rruge, struktura dhe te tjerat per te rikthyer ate pjese toke te shfrytezuar per punime te perkohshme ne gjendjen e meparshme ose ne nje gjendje tjeter sipas kerkeses se Menaxherit te Projektit dhe pronarit te tokes si dhe ne perputhje me kushtet e vena ne miratimet e marra para fillimit te punimeve.

1102.3 Strukturat ekzistuese dhe sherbimet nentokesore

Ne rastet kur kemi ekspozim apo demtim te ndonje themeli, muri, shkarkimi, kullimi, tubi, teli, kablli apo te ndonje strukture, vendi dhe sendi tjeter ekzistues gjate kryerjes se Punimeve ndertimore te Kontrates ata duhet te mirembahen ne menyren e duhur dhe te mbrohen mjaftueshem si dhe te adoptohen ne menyre te tille qe te parandalohet nderprerja apo mos funksionimi dhe te garantohet perdorimi i sigurte dhe i

vazhdueshem i sherbimeve te mesiperme sipas miratimeve te Menaxherit te Projektit.

1102.4 Trajtimi i Ujrave

Vetem nese specifikohet ndryshe, Kontraktori duhet te marre parasysh te gjithë rreziqet nga ujrat, qofte keto nga lumenjte kryesore, perrenjte lokal, burimet nentokesore ose cdo lloj burimi apo shkaku tjeter. Kontraktori duhet te siguroje dhe te perdore cdo lloj impianti, makineri, pompe dhe mjete te ngjashme te nevojshme. Kontraktori do te jete pergjegjes per pompimin e te gjithë ujrave te dala nga germimet. Gjate heqjes se ujit, Kontraktori duhet te shmange permbytjen e punimeve te tjera, ndotjen te burimeve ujore dhe te mos shkaktoje gerryerje.

Kur punimet e perkoheshme kalojne permes ose jane brenda burimeve ujore, Kontraktori duhet te projektoje dhe rregulloje punimet e tij te perkohshme ne perputhje me kerkesat e autoriteteve per rrjedhjen e ujit, shmangien e ndotjes etj.

1102.5 Dispozita te vecanta per dimrin

Kontraktori duhet t'i paraqese Menaxherit te Projektit per miratim nje plan te vecante trafiku per periudhen Nentor-Mars i cili detajon: a) masat paraprake te propozuara para fillimit te dimrit dhe b) mirembajtjen e propozuar te trafikut ekzistues brenda Objektivit te Punimeve gjate periudhes se dimrit.

1102.6 Kontraktore te tjere

Kontraktorit i behet e ditur qe Kontraktore dhe te punesuar te tjere nga Punedhenesi mund te punojne brenda dhe rreth Objektivit. Kontraktori duhet te komunikojë me Punedhenesin dhe duhet te planifikojë dhe kryejë Punimet ne interes te te gjitha paleve dhe te siguroje progres te kenaqshem te projektit.

Kontraktori, te punesuarit dhe nenkontraktoret e Kontraktorit duhet te respektojne ndertimin dhe perfundimin e punimeve dhe artikujt e furnizuar apo instaluar nga te tjeret dhe do te jene pergjegjes per cdo humbje ose demtim te shkakuar nga Kontraktori ose personeli i tij.

1102.7 Vizatimet e “faktit”

Kontraktori duhet te mbaje shenime gjate kryerjes se punimeve ne formen e Vizatimeve te “faktit” per mirembajtjen e. Menaxheri i Projektit do t'i disponoje keto Vizatime te Faktit per inspektime te here pas hereshme. Me perfundimin e punimeve dhe jo me shume se 28 dite pas Dates se Pritshme te Perfundimit, Kontraktori do te paraqese tek Menaxheri i Projektit dy kopete ne te Vizatimeve te Faktit qe mbulojne te gjithë ndertimet gjate Punimeve te mirembajtjes Rutine. Te gjitha shenimet te mbajtura gjate kryerjes se Punimeve do te shoqerrojne Vizatimet e Faktit.

1103 ZOTERIMI DHE PERDORIMI I OBJEKTIT

Kontraktori do te kete pergjegjesi per perdorimin e rrugeve brenda Objektivit te Punimeve, ne perputhje me Ligjin dhe Rregullat Shqiptare.

Kontraktori do t'i kerkoje Menaxherit te Projektit zoterimin e objektit ose te nje pjese te tij, ne perputhje me programin e tij te Punimeve, dhe Punedheneesi duhet te jape zoterimin sipas Klauzoles perkatese te Kushteve te Kontrates. Zoterimi i Objektit nuk do te jepet n.q.se nuk eshte miratuar Sistemi i Menaxhimit te Trafikut (Klauzola 1112 e Specifikimeve).

Me dhenien e zoterimin e Objektit ose te nje pjese te tij, Kontraktorit duhet t'i jepet dhe autoriteti qe te zhvilloje Punimet, sipas udhezimeve te Menaxherit te Projektit dhe Kontrates se lidhur.

Kontraktori nuk duhet te hyje ne Objekt per shqyrtime te tjera, apo per te kryer Punime derisa t'i jepet zoterimi. N.q.se Kontraktori kerkon te hyje per disa arsye, per te cilat bie dakord me Menaxherin e Projektit, kur ende nuk ka marre zoterimin, ai duhet te tregojte qe ka marre masat e nevojshme dhe te sigurta per te vepruar.

Gjate periudhes se zoterimit te Objektit, ose te nje pjese te tij, Kontraktori do te jete pergjegjes per sigurimin e ndricimit, mbrojtjes dhe masave te tjera per te garantuar punimet e perkoheshme, materialet e depozituara, germimet, punimet pjeserisht te perfunduara, etj, per perdorimin publik dhe rrugor.

1104 MIRATIMI I PUNIMEVE MUJORE NGA MENAXHERI I PROJEKTIT

Per inspektimin e Objektit dhe miratimin e Punimeve Mujore, Kontraktori duhet te jape lajmerojte Menaxherin e Projektit ne kohe dhe me shkrim. Kur periudha e lajmerimit nuk eshte percaktuar ne Kontrate, lajmerimi nuk duhet bere ne me pak se kater (4) ore pune para se puna te jete gati per inspektimin final. Do te perdoren formularet e lajmerimit nqs keto te fundit ekzistojne. Asnje punim nuk duhet te filloje pa miratimin e meparshem me shkrim te Menaxherit te Projektit.

Kjo nuk do te cliroje Kontraktorin nga kerkesa e tij per te perfunduar punen e tij ne perputhje me programin mujor.

Menaxheri i Projektit do te kerkoje kohe te arsyeshme gjate orarit normal te punes per te kryer inspektimet e tij.

1105 HYRJA NE PRONE

Kontraktori duhet te mbaje hapur te gjitha hyrjet per ne pronen e rruges gjate kryerjes se Punimeve. Kur mbyllja e hyrjeve eshte e paevitueshme, sipas marreveshjes me Menaxherin e Projektit dhe perafritimit te punimeve, Kontraktori duhet te lajmerojte ne kohe te mjaftueshme zoteruesit e prones se ndikuar per operacionet qe do te zhvillohen, ne menyre qe te minimizohen veshtiresite dhe te sigurohet hyrje e mundshme ne cdo kohe. Ne asnje rast nuk duhet te mbyllen hyrjet per me shume se 12 ore.

1106 SHERBIMET

Kontraktori do te jete pergjegjes per cdo dem te shkaktuar prej tij ne sherbimet e njohura, derisa te provoje qe kishte marre te gjitha masat praprake dhe qe demi eshte shkaktuar per shkak se pozicioni i sherbimit te njohur ka devijuar per me shume se nje meter nga pozicioni, sic mund te jete pare nga studimet e bera nga vete ai.

1107 SIGURIMI I SHERBIMIT 24 ORE I KONTRAKTORIT ME PERSONELIN KRYESORE

Kontraktori duhet te siguroje personel kryesor me mjete dhe sherbime komunikimi per situata emergjence dhe ndihme.

Kontraktori duhet te parashikojte per te gjitha personelin e tij kryesor dhe sherbimet e komunikimit perfshire ketu (por jo kufizuar vetem ne) blerjen, marrjen me qera, sherbimin, kostot e regjistrimit ose detyrime dhe kuotizacione te tjera.

Sistemi i sherbimeve te komunikimit duhet te sigurohet pas miratimit te Menaxherit te Projektit brenda 14 diteve nga Data e Fillimit.

Kontraktori duhet te jape brenda zerave ne Preventiv shpenzimet per komunikime te tilla.

1108 NGRITJA E KANTIERIT NE AFERSI TE OBJEKTIT

Kontraktori duhet te gjeje Kampin ose Kampet e tij per te ngritur kantierin e tij me zyrat, repartet, magazinat, etj.

Kontraktori duhet te vendose nje kamp ne aferti te objektit te pajisur me te gjitha sherbimet per pjemarresit gjate kohezgjatjes se Kontrates.

Me perfundimin e Punimeve, Kontraktori duhet zhvendose te gjitha zyrat e tij, repartet, magazinat, kampin, etj dhe te pastroje Objektin e ta ktheje ne gjendjen fillestare sipas udhezimeve te Menaxherit te Projektit dhe Planit te Menaxhimit te Mjedisit.

Kontraktori duhet gjithashtu te percaktojte zonat e tij per grumbullimin dhe depozitimin e mbeturinave dhe materialeve qe nuk i nevojiten me, sipas procedurave lokale per transport dhe zhvendosje te mbeturinave.

Kontraktori do te jete pergjegjes per marrjen e te gjitha miratimeve dhe lejeve nga pronaret dhe organizatat perkatese per kompleksin e kampeve, sipas Klauzoles 1102.2. te ketyre Specifikimeve.

1109 RUAJTJA E MJEDISIT

Kontraktori, gjate kohes se kryerjes se Punimeve duhet te ruaje mjedisin sipas rregullave dhe legjislacionit aktual te mbrojtjes se mjedisit. Ai duhet te siguroje te gjitha informacionin rreth Organizatave per Mbrojtjen e Mjedisit ne Shqiperi, autorizimet dhe miratimet zyrtare ose nje licence punimi nga Agjensia Kombetare e Mjedisit ne Shqiperi (AKMSH) per te gjitha punimet e perkoheshme, depozitimet, guoret dhe pikat e furnizimit.

Miratimet duhet te perfshijne por jo te kufizohen vetem ne:

- Instalimet dhe masat per mbrojtjen e mjedisit (uji, ajri, dheu) gjate kryerjes se Punimeve.

- Propozimet rreth filtrimit të gazeve të djegur.
- Metoden e depozitimit të materialeve dhe masave të marra për mbrojtjen e mjedisit
- Metoda e pastrimit të automjeteve pasi lenë Objektivin.
- Sasine dhe burimin e ujrave të përdorura.
- Metoden e grumbullimit dhe zhvendosjes së ujit të përdorur apo të çfaredo materiali tjetër të lengshëm apo të ngurtë, përfshirë mbeturinat e rezultuara nga mirembajtja e kantierëve dhe sasine të depozituara.
- Furnizimin me karburante, depozitimin dhe llojin e karburantit të përdorur.
- Guroret dhe pikat e furnizimit.

Kontraktori do të jetë përgjegjës për mbrojtjen e pasurive të paluajtshme, tubacioneve, të mbjellave, pemëve, monumenteve historike, shenjave rrugore, gardheve, vreshtave, kopshteve dhe çdo lloj prone të luajtshme apo të paluajtshme të një individi apo kompanie, nga pluhuri, tymrat, smogu dhe efektet e demshme kimike të bitumit apo materialeve të tjera.

Kontraktori do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për pakesimin e përhapjes dhe clirimit të pluhurit, gazit, zhurmave etj, duke bërë sperkatje me ujë të çdo rruge të paasfaltuar apo depozitime granilesh duke përdorur filtra, duke mbuluar gjeneratorët, pompat dhe duke kryer kontrolle dhe kujdesje të përgjithshme.

Kontraktori duhet t'i mbulojë kamionet gjatë transportimit të materialeve.

Kontraktori, gjatë përdorimit të një fabrike të miratuar asfalti, duhet të paraqesë tek Menaxheri i Projektit masat e planifikuara për shmangien e zhurmës dhe ndotjes së mjedisit në atë zonë. Agjensite Rajonale të Ministrisë së Mjedisit do të bëjnë matjet, por Kontraktori duhet t'i paraqesë rezultatet tek Menaxheri i Projektit.

Niveli i zhurmave gjatë një dite pune kur punohet në zona urbane nuk duhet të jetë më i lartë se 70dB_Laeq (dyfish i zhurmës mesatare) matur në një pikë në murin më të afërt të ndërtesës me të afërt të Objektivit.

Vlerat e pranueshme për ndotjen e ajrit dhe të tokës do të jenë:

- | | |
|----------------------|-----------------------------------|
| - Dioksid squfuri | < 0.25 mg/m ³ në ditë |
| - Adeland | < 0.012 mg/m ³ në ditë |
| - Benzine | < 0.8 mg/m ³ në ditë |
| - Pjesë të nderprera | < 0.15 mg/m ³ në ditë |

Regullat Shqiptare në fuqi në lidhje me vlerat e pranueshme do të mbizoterojnë.

Kontraktori, me kërkesën e Menaxherit të Projektit do të kryejë të gjitha procedurat e mjedisit që kerkohen për të demonstruar respektimin e kërkesave të kesaj Klauzole.

Kostoja e një procedure të tillë do të përfshihet në cmimet njësi të Kontraktorit.

Aksi do te jete aksi i rruges ekzistuese.

Nuk do te perdoren materiale apo produkte, cilesia e te cileve nuk eshte certifikuar me certifikate cilesi ne kohën e dorezimit nga prodhuesit, e cila te specifikojë perputhjen e tyre te plote me kerkesat perkatese. Kontraktori duhet te paraqese miratimin zyrtar ose nje licence te vlefshme operimi nga Agjensia Kombetare e Mjedisit ne Shqiperi, lidhur me produktet apo materialet qe do te perfshihen ne Punimet.

Kontraktori do te jete plotesisht pergjegjes per garantimin e cilesise per te gjitha materialet dhe punetoresise ne perputhje me Specifikimet dhe kerkeses se Menaxherit te Projektit.

Kontraktori duhet te kryeje inspektimin e vet te materialeve dhe punetorise per te qene i sigurt qe ato jane sipas Specifikimeve perpara se t'ia paraqese Menaxherit te Projektit per miratim apo pagese.

Nuk do te kete pagese te vecante per Kontraktorin per punen e tij lidhur me inspektimin dhe marrjen e kampioneve per berjen e testeve. Kostoja e kesaj pune do te perfshihet ne cmimet njesi te Kontraktorit

Menaxheri i Projektit do te leshoje Procesverbale Mosperputhshmerie per materialet, punetorine, punen apo pjese tjeter qe nuk eshte ne perputhje me Kontraten. Derisa procesverbali te mos terhiqet Menaxheri i Projektit nuk do te beje asnje pagese per zerat perkates te punimeve.

Kur nje Kontraktor i jep Menaxherit te Projektit detaje te furnizimit te materialeve qe do te futen ne Punime, Menaxheri i Projektit do te kerkoje kohe per te testuar materialet perpara se te jape miratimin e tyre.

Kontraktori duhet te veproje ne perputhje me dispozitat e Standardit AASHTO. Kontraktori mund te propozoje perdorimin e Standardeve alternative dhe te kryeje Punimet ne perputhje me keto Standarde alternative me miratimin e Menaxherit te Projektit dhe te personit te miratuar nga Punedhenesi duke siguruar qe ato standarde ofrojne te njejten cilesi ose nje cilesi me te mire.

Specifikimet qe jane pjese e Dokumentave te Tenderit dhe te cilave u referohemi si Specifikime Teknike do te lexohen se bashku me Metoden Pagesave dhe pershkrimin e Zerave. Ne rast mosperputhjeje, Menaxheri i Projektit do te vendose se cili version do te kete perparesi.

Kontraktori duhet qe, perpara se te porosise materialet qe do te futen ne Punime, te paraqese tek Menaxheri i Projektit nje informacion te plote rreth tyre.

Ky informacion duhet te perfshije emrat e furnizuesve, origjinen e materialeve, specifikimet prodhuese, cilesi, pershkrimet, bashke me te gjitha detajet e materialeve qe ai propozon dhe per secilen firme. Kontraktori duhet te depozitoje se bashku me Menaxherin e Projektit a) kampione te ketyre materialeve kur kerkohen dhe b) kur kerkohet, certifikatat e prodhuesit te testeve te fundit te kryera ne materiale te ngjashem.

Per inspektimin e Objektivit dhe miratimin e punimeve, lajmerimi duhet te jepet sic

pershkruhet ne Klauzolen 1104 te ketyre specifikimeve.

Kontraktori do te beje c'eshte e nevojshme per te lehtesuar / mundesuar cdo lloj kontrolli (studim apo test laboratorik) qe do te beje Menaxheri i Projektit.

1111 SISTEMI I GARANTIMIT TE CILESISE PER PUNIMET E INXHINIERISE CIVILE

Sistemi i garantimit te cilesise i aplikuar per punimet civile eshte nje sere procedurash organizative, pergjegjesish, rregullash dhe burimesh per te arritur cilesine e kerkuar per punimet e inxhinierise civile.

Sistemi i garantimit te cilesise i aplikuar per punimet civile duhet te konsistoje ne :

- Rregullat, normat dhe standardet teknike te inxhinierise civile;
- Cilesine e materialeve te perdorura per punimet inxhinierike civile;
- Miratimet teknike lidhur me cilesine e produkteve dhe procedurave te reja;
- Inspektimet e projekteve dhe punetore si dhe ekzaminimet e specialisteve te projektimit te punimeve ndertimore.
- Garantimin dhe menaxhimin e cilesise se punimeve ndertimore;
- Miratimin dhe certifikimin e laboratoreve ku jane kryer testet dhe analizat e punimeve laboratorike;
- Aktivitetin meteorologjik lidhur me punimet ndertimore;
- Pranimin e punimeve ndertimore; (dorezim te perkohshem dhe perfundimtar)
- Ecurine dhe permisimin e operacioneve te punimeve ndertimore;
- Mirembajtjen e punimeve ndertimore
- Inspektimin e cilesise se punimeve ndertimore;

Kur kerkohet plotesimi i nje kerkese perkatese cilesie ne perputhje me specifikimet e cilesise duhet te perdoren vetem produkte, procedura dhe makineri shtese te miratuara me pare.

Labororet e testimit dhe te provave do te miratohen dhe autorizohen ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Matja e punimeve ndertimore do te zhvillohet ne perputhje me dispozitat ligjore persa i perket kalibrimit, besueshmerise se kerkuar ne kontroll dhe operim te mjeteve te perdorura per matje dhe kontroll.

Kontraktori do te jete plotesisht pergjegjes per sigurimin e cilesise te te gjitha materialeve dhe punetore sipas Specifikimeve dhe kerkesave te Menaxherit te Projektit.

Kontraktori duhet te kryeje inspektimin e vet te materialeve dhe punetore per te qene i sigurt qe ato jane sipas Specifikimeve perpara se t'ia paraqese Menaxherit te Projektit per miratim apo pagese.

Kontraktori do te pergatise dhe te paraqese tek Menaxheri i Projektit brenda 60 diteve nga marrja e Letres se Pranimin nje sistem (te shkruar) menaxhimi te garantimit te cilesise i ngjashem me ate qe pershkruhet ne serine ISO 9000 ose sipas marreveshjes

me Menaxherin e Projektit. Ky sistem duhet te paraqese organizimin e Objektivit dhe pergjegjesite e Kontraktorit per te gjitha anetaret e organizates se Kontraktorit per te kontrolluar dhe raportuar mbi cilesine e materialeve dhe te puntorise. Ai duhet te paraqese, gjithashtu, edhe procedurat e komunikimit me Menaxherin e Projektit.

1112 SISTEMI I MENAXHIMIT TE TRAFIKUT

Perpara Dates se Fillimit, Kontraktori duhet te paraqese tek Menaxheri i Projektit per miratim nje Plan te pergjithshem te Menaxhimit te Trafikut (TMP) ku do te pershkruaje se si do te minimizojte impaktin e punimeve ndertimore ne qarkullimin rrugor publik. Ky TMP do te tregojte ne pergjithesi se si kontraktori do te mbroje puntorine duke vene paraprakisht shenjat paralameruese ne rruge si dhe kone perreth zones ku punohet qe eshte percaktuar nga kontraktori. TMP do te tregojte numrin, tipet e shenjave rrugore dhe koneve qe do perdoren per te rrethuar zonen ku do punohet. TMP duhet te aprovohet nga Manaxheri i Projektit para se te fillojne pergatitjet e planeve mujore.

Gjate zbatimit te kontrates, Kontraktori do te dorezoje Planet specifike te manaxhimit te trafikut sebashku me "programin mujor te punimeve" para fundit te cdo muaji. Keto TMP specifike do te perfshijne te gjitha detajet e manaxhimit te trafikut qe kontraktori do ti zbatoje gjate punes, dhe qe do te ndikojne direkt ne qarkullimin rrugor. TMP specifike do te perfshijne propozimet e kontraktorit per shenjat e trafikut, ndicimin, etj sipas cdo zone pune ku do te punojte. Duhet te jape me detaje numrin dhe tipin e shenjave paralajmeruese ne rruge, qe jane aprovuar paraprakisht ne planin e pergjithshem dhe qe do perputhet me planin mujor te punimeve. Gjithashtu do te vendosen numri dhe vendi specifik ku do te jene konet qe do te rrethojne zonen dhe do te mbrojne punetoret qe po bejne punimet e mirembajtjes. TMP specifike do te aprovohen nga Manaxheri i Projektit sebashku me planet mujore te punes. Nese kontraktori nuk dorezon TMP sipas kerkesave atehere Manaxheri i Projektit nuk do ta aprovoje Planin Mujor te Puneve.

Kontraktori duhet te marre te gjitha masat e nevojshme per te drejtuar trafikun ne devijacionet e krijuara gjate dites dhe nates.

Policia dhe Menaxheri i Projektit do te bien dakort per kufizimet ne gjeresine e rruges. Qellimi eshte qe te menjahohen kohet dhe rradhet e gjata ne pritje.

Nuk do te filloje asnje punim derisa autoritetet perkatese dhe Menaxheri i Projektit te jene te bindur qe po perdoren rregullat e adaptuara.

Kur ne Planin mujor te Menaxhimit te Trafikut nuk pershkruhen rrethanat e ndonje rasti te vecante, Kontraktori duhet t'i paraqese Menaxherit te Projektit per miratim propozime per trajtimin e situatave te tilla. Perputhja me kete Klauzole nuk do ta cliroje Kontraktorin nga asnje prej detyrimeve dhe pergjegjesive te tjera te Kontrates.

Kontraktori do te siguroje complete shenjash standarde dhe veshjesh reflektive per nje numer te caktuar punetoret dhe Kontraktori duhet te mirembaje ose zevendesojte shenjat dhe rrobat reflektive gjate kryerjes se punimeve dhe riparimit te ndonje difekti.

Gjithashtu duhet qe:


- Te kete kujdes te plote per te gjithë personat edhe nese nuk jane te autorizuar per te qene ne Objekt, dhe te mbaje Objektin ne kushte te tilla qe te menjanoje cdo lloj rreziku per te gjithë personat; dhe
- Te mirembaje ose te zevendesoje me shpenzimet e tij, ndricimin, barrierat dhe shenjat paralajmeruese, ku dhe kur eshte e nevojshme, ose kur kerkohen nga Menaxheri i Projektit per mbrojtjen e Punimeve ose per sigurine e publikut. Ai duhet te zevendesoje edhe rrobat me reflektim te dobet per punetoret e tij, kur eshte e nevojshme apo instruktohet nga manaxheri i Projektit.

Kontraktori duhet t'i mbaje te pastra dhe te lexueshme gjate gjithë kohes shenjat e trafikut, treguesit e rruges, llampat dhe sinjalet kontrolluese te trafikut si dhe ti vendose, rivendose, mbuloje dhe levize ato sipas nevojës se ecurisë se Punimeve.

Kontraktori do te informoje Menaxherin e Projektit me shkrim, brenda dy javeve nga Data e Fillimit te Punimeve, per emrin e personit pergjegjes qe do te siguroje gjate gjithë kohes perputhjen me kete Kaluzole.

Gjate kryerjes se punimeve, Kontraktori duhet te siguroje qe kunetat te mbahen te pastra nga dherat, balta apo materiale te tjera te lira, qe te mos pengojne rrjedhjen e ujerave.

Kontraktori duhet te perfsije ne cmimin e tij ne Preventiv dhe masat qe duhen marre per sigurimin dhe kontrollin e trafikut.



1200 SPECIFIKIMET TEKNIKE

TABELA E PERMBAJTJES

| | |
|------|--|
| 1201 | HAPESIRA..... |
| 1202 | PASTRIME..... |
| 1203 | NIVELIMI I BANKINAVE DHE MBUSHJEVE..... |
| 1204 | PERPUNIMI SIPERFAQESOR..... |
| 1205 | ASFALTIMI ME PENETRIM DHE ASFALTI I PARAPERGATITUR..... |
| 1206 | MAKADAMI I LIDHUR ME UJE..... |
| 1207 | MATERIALI GRANULAR |
| 1208 | LLACI I CIMENTOS..... |
| 1209 | RIPARIMET E STRUKTURAVE TE BETONIT..... |
| 1210 | LYERJA E GUREVE EKZISTUES TE KILOMETRAZHIT DHE SHENJAVE HORIZONTALE DHE VERTIKALE |
| 1211 | DITEPUNE..... |
| 1212 | SIGURIMI DHE ZEVENDESIMI I MBROJTESEVE METALIKE (GUARDRAIL) |
| 1300 | METODA E PAGESES DHE PERSHKRIMI..... |

1201 HAPESIRA

Ky seksion mbulon punimet qe duhet te kryhen per mirembajtjen rutine.

Punimet civile konsistojne ne:

- Patrimin e kunetave anesore ne drejtimin dhe kuoten e duhur;
- Pastrimin e tombinove ekzistuese rrethore dhe kuti;
- Nivelimin e bankinave dhe mbushjeve;
- Furnizimin dhe vendosjen e perpunimit siperfaqesor ose asfaltit te parapergatitur ne gropat e pergatitura;
- Riparimin e punimeve ekzistuese te betonit ose tulle;
- Lyerjen e strukturave ekzistuese te rruges;
- Menaxheri I Projektit mund te udhezoje punime te tjera.

Shenim: te gjitha aktivitetet e mesiperme do te perseriten, nqs eshte e nevojshme, gjate kohezgjatjes se kontrates. Kjo do te percaktohet ne baza mujore me pergatitjen nga kontraktori te “Programeve mujore te Punes” bazuar ne inspektimin e te gjithe seksionit.

Inspektimi i Kontraktorit do te percaktoje nevojten e nderhyrjes per pastrim, riparim dhe zevendesim zerash, ne perputhje me ‘nivelein e kerkuar’ dhe ‘nivelein minimal’ te sherbimeve te percaktuara ne Specifikimet Seksioni B.1 “ peshkrimi i zerave te punes’.

Programi mujor i puneve, i pergatitur, do t’i dorezohet Manaxherit te Projektit, ose perfaqesuesit te tij, per aprovim 7 (shtate) dite para fundit te muajit. Projekt Manaxheri ose perfaqesuesi i tij, do ta aprovojne planin mujor te punimeve ose do te kerkojne modifikim me aprovimin e kontraktorit, para fundit te muajit.

Plani mujor i punimeve do te perbeje bazat e punimeve qe do te kryhen nga kontraktori gjate muajit dhe punimet e percaktuara do te kryhen plotesisht ne menyre qe te merret pagesa e plote mujore qe eshte ne preventiv. Cdo mosrealizim sipas planit mujor te punimeve do ti shkaktonte kontraktorit marrjen e ‘pikeve te denimit’ ne perputhje me specifikimet Seksioni A.5 ‘ shlyerja e dentimeve’, ne te cilin tregohen zbritjet ne pagesat mujore te Kontraktorit, ne perputhje me Specifikimet Seksioni A.5.3 “piket e denimit”.

Keto Specifikime Teknike aplikohen per Punimet e mirembajtjes rutine dhe perfshijne kushtet baze teknike qe duhet te plotesohen gjate kryerjes se Punimeve te perfshira ne Preventiva si dhe te udhezuara nga Manaxheri i Projektit.

Kontraktori do te kryeje te gjitha testimet dhe zbatoje te gjitha kerkesat e tjera qe kerkohen nga keto Specifikime Teknike ne nje laborator te autorizuar.

Kontraktori, me kerkesen e Manaxherit te Projektit dhe te Punedhensesit, do te kryeje teste suplementare, pervec testeve te kerkuara nga keto Specifikimeve Teknike.

Kontraktori duhet te garantoje ndermarrjen e te gjitha hapave organizative dhe teknologjike qe cojne ne ndjekjen strikte te ketyre Specifikimeve Teknike.

Ne rast devijimi te ketyre Specifikimeve Teknike, Manaxheri i Projektit mund te

urdheroje nderprerjen e Punimeve dhe te udhezoje cdo lloj veprimi te nevojshem, i cili do te kryhet me shpenzimet e Kontraktorit.

Te gjitha Punimet do te maten ne perputhje me Sistemin Metrik.

1202 PASTRIME

Kontraktori duhet te pastroje kunetat, kanalet anesore, K.U.Z .dhe K.U.B. dhe tombinot rrethore dhe kuti ekzistuese deri ne kouten dhe drejtimin fillestar, ne perputhje me Specifikimet, Klauzola B.1 Zeri 2.1 dhe 2.3.

Kontraktori duhet te garantoje pastrimin e te gjitha kanaleve anesore, kunetave dhe tombinove nga lluca, balta, materialet e tjera te lira per te lejuar rrjedhjen e lire te ujit.

Kontraktori do te heqe te gjithe guret e rene ne rruge (specifikimet B.1 Zeri 2.9).

Kontraktori duhet te largoje dhe depozitoje jashte zones ne pronesi te rruges te gjitha materialet e germuara, fshira apo Rutine, Dimerore dhe Rutine ne nje vend te miratuar nga Menaxheri I Projektit dhe ne perputhje me Planin e Menaxhimit te Mjedisit.

Materialet e rezultuara nga pastrimi duhet te depozitohen ne vende te ndara si te pershtatshme dhe te papershtatshme. Materialet e pershtatshme duhet te perdoren ne rindertimin e mbushjeve dhe bankinave ekzistuese sipas udhezimeve te Menaxherit et Projektit..

Kanalet anesore, tombinot ekzistuese rrethore dhe kuti duhet te pastrohen duke ruajtur seksion fillestar terthor, nivelin e bazes dhe pozicionin ne profil dhe sipas udhezimeve te Menaxherit te Projektit.

1203 NIVELIMI I BANKINAVE DHE MBUSHJEVE

Drejtimi dhe kuot e nivelimit te bankinave dhe mbushjeve ekzistuese do te behet ne perputhje me Specifikimet , Klauzola B.1 Zeri 2.7.

1204 PERPUNIMI SIPERFAQESOR

Ky seksion mbulon aplikimin e nje trajtimi te vetem ose te shumefishte te siperfaqeve te pergatitura.

Siperfaqet duhet te priten me forme dhe me ane.

Kjo pune do te konsistoje ne furnizimin dhe aplikimin e prajmerit dhe perpunimin e vetem apo te shumefishte te siperfaqes me cakull dhe emulsion bituminoz (tack coat) ne zonat e parapergatitura.

Secila shtrese do te kurohet per 4 dite para se te hidhen shtresat e tjera.

Do te aplikohen Specifikimet ne Pjesen I per perpunimin siperfaqesor.

a) Prajmeri

Kjo pune konsiston ne trajtimin e siperfaqeve te pergatitura me para, me materiale asfaltike dhe materiale thithese, ne qofte se kerkohet. Materiali thithes duhet te jete rere e paster natyrale.

Para se te beje sperkatjen me prajmer, Kontraktori duhet te garantoje qe siperfaqja qe do te lyhet me prajmej eshte profiluar ne pjerresine dhe seksionin e kerkuar, nuk permban brazda, vijejime, materiel te lira ose parregullsi te tjera, dhe eshte e ngjeshur ne menyre uniforme.

Prajmeri nuk duhet te aplikohet re rastet e motit me mjegull, debore ose kushte lageshtire apo kur siperfaqja eshte e lagesht.

Eshte e ndaluar qe te sperkatet me prajmer nje siperfaqe me lageshtire ose kur temperatura e siperfaqes eshte me pak se 10° C ose kur kushtet atmosferike mund te mos lejojne penetrimin e prajmerit.

Menaxheri i Projektit duhet te miratoje siperfaqen qe duhet lyer me prajmer dhe do te vendose ai nese do te aplikohet prajmeri ne kushte te vecanta atmosferike apo jo. Prajmeri duhet te jete asfalt i lengshem MC-30 ose MC-70 ose asfalt emulsiv,ose sipas specifikimeve te Menaxherit te Projektit.

Ne Tabelen 1 jepen temperaturat e ruajtjes dhe te aplikimit.

Tabela 1

| Lloji dhe marka e materialit | Sperkatja °C | Ruajtja °C deri ne dhe mbi 24 ore |
|------------------------------|--------------|-----------------------------------|
| MC-70 | 60-80 | 80-50 |
| MC -30 | 45 – 60 | 65-30 |
| CSS-1 | 30-50 | 50-10 |

Prajmeri duhet te aplikohet ne nje perqindje prej 0,9 l/m² (kjo perqindje jepet per qellime tenderimi). Megjithate, perqindja reale e aplikimit do te percaktohet kur te shrohet nje seksion prove dhe nga udhezimet e Menaxherit te Projektit.

Perqindja reale e sperkatjes nuk duhet te devijojte me me shume se 0.05 l/ m² nga perqindja e kerkuar qe specifikohet apo udhezohet nga Menaxheri i Projektit.

Nuk duhet te lejohet kalimi i trafikut mbi siperfaqen e sperkatur me prajmer derisa materiali bituminoz te kete penetruar dhe te jete thare dhe, sipas gjykimit te Menaxherit te Projektit, nuk do te hiqet nga trafiku. Ne qofte se lind nevoja qe te lejohet trafiku mbi siperfaqe me shpejt sec duhet, por ne asnje rast me pare se 24 ore pas aplikimit te materialit bituminoz, do te aplikohet material thithes sipas udhezimeve te Menaxherit te Projektit dhe pastaj mund te lejohet trafiku mbi keto korsi.

Kontraktori duhet te mirembaje siperfaqen e sperkatur me prajmer ne gjendje te paster dhe gati per aplikimin e shtreses tjeter.

b) Emulsioni Bituminoz (tack coat)

Kjo pune do te konsistoje ne furnizimin dhe aplikimin e bitumit te holluar emulsion mbi siperfaqet e pergatitura me pare, per te siguruar perpun siperfaqesor tek ose te

shumefishte. Perqindja e aplikimit qe jepet ne tabelat 4 dhe 5 eshte per qellime tenderimi. Perqindja reale do te percaktohet kur te shtrohen seksionet prove dhe sipas udhezimeve te Menaxherit te Projektit.

Emulsioni bituminoz nuk duhet te aplikohet kur temperatura e ambientit eshte me pak se 15 ° C, dhe as ne mot me shi, mjegull, debore apo ne kushte te tjera atmosferike te papershtatshme.

E gjithë siperfaqja qe do te trjatohet duhet te pastrohet nga pluhuri, papastertite dhe materialet e tjera penguese. Te gjitha gropat, carjet ose vrimat dhe gervishtjet e materialeve bituminoze duhet te korrigojohen ne perputhje me udhezimet e Menaxherit te Projektit.

Materiali bituminoz duhet te aplikohet menjehere pas pastrimit te siperfaqes. Siperfaqet e strukturave, bordurave dhe pjeseve te tjera ne afersi te zonave qe trajtohen duhet te mbrohen ne nje menyre te tille qe te mos sperkaten apo piklohen. Pas aplikimit, siperfaqja duhet te thahet deri ne gjendjen e duhur te ngjitjes per te hedhur shtresen mbuluese. Emulsioni bituminoz duhet te aplikohet aq kohe perpara shtreses mbuluese sa i duhet per te perftuar gjendjen e ngjitjes. Deri sa te vendoset shtresa mbuluese, Kontraktori eshte i pergjegjshem te mbroje emulsionin nga demtimi. Ne rast se nuk shmanget dote demtimi nga shiu apo pluhuri i emulsionit bituminoz, atehere ai duhet te lihet te thahet. Pastaj, do te pastrohet perseri me nje fshese korrenti, dhe nqs kerkohet nga Menaxheri i Projektit, do te aplikohet nje lysterje tjeter e lehte mbi po ate siperfaqe. Per kete pune nuk do te behet asnje pagese shtese.

Clirimi i grimcave te emulsionit bituminoz duhet te jete pozitiv. Ne qofte se testi i clirimit te grimcave nuk eshte bindes, do te pranohen materiale me velre pH prej 6,7. Menaxheri i Projektit do te vendose nese do te aplikohet testi i elektrodës.

c) Materialët e thyera / Granilet

Granilet e trasha do te konsistojne ne gure ose zhavorr te thyer, qe perbehen nga copa dhe fragmente me cilesi uniforme. Granilet duhet te jene te pastra nga argjila, bimët apo materiale te tjera shkaterruese, dhe nuk duhet te kene asnje pjese te veshur me argjile, papasterti dhe pluhur.

Kerkesat per granilet jepen ne tabelen 2.

Tabela 2

| Treguesit | Nr. i proves sipas AASHTO | Kerkesa |
|----------------------------------|----------------------------------|----------------|
| Fortesia e Sodium sulfate | T 104 | < 12 % |
| Tregusi i Plasticitetit | T 90 | Jo plastike |
| Treguesi i kohezgjatjes | T 210 | > 35 |
| Perqindja e konsumimit (L. A.) | T 96 | < 35 |
| Pluhuri i mbetur mbas larjes | T 11 | < 1 % |
| Ekuivalenti i reres | T 176 | > 35 % |
| Veshje dhe rrjepje | T 182 | > 95 % |
| Marrja e Kampioneve | T 2 | |
| Granulometria (analiza e sites) | T 27 | |

Granulometria do te jete sipas kerkesave te tebeles 3.

Tabela 3

| Sita (ne mm) | Granulometria , % kalim masiv | | | | |
|--------------|-------------------------------|--------|--------|--------|--------|
| | 19mm | 13,2mm | 9,5mm | 6,7mm | 4,75mm |
| 26,50 | 100 | - | - | - | - |
| 19,00 | 85-100 | 100 | - | - | - |
| 13,20 | 0-30 | 85-100 | 100 | - | - |
| 9,50 | 0-5 | 0-30 | 85-100 | 100 | - |
| 6,70 | - | 0-5 | 0-30 | 85-100 | 100 |
| 4,75 | - | - | 0-5 | 0-30 | 85-100 |
| 3,35 | - | - | - | 0-5 | 0-30 |
| 2,36 | - | - | - | - | 0-5 |

Indeksi maksimal i petezimit duhet te jete:

-per masen nominale te granileve 13.20 mm dhe 19.00 mm < 25 %

-per masen nominale te granileve 6.70 mm and 9.50 mm < 30 %

d) Aplikimi i granileve dhe emulsionit bituminoz

Granilet dhe emulsioni bituminoz duhet te aplikohen sic specifikohe me siper.

Perqindjet e meposhtme nominale te aplikimit tek (tabela 4) do te perdoren per qellime tenderimi:

Tabela 4

| Masa nominale d/D mm | Vlerat nominale te aplikimit | |
|----------------------|--|------------------------------|
| | Emulsioni bituminoz l / m ² | Granile kgs / m ² |
| 13,2/19,0 | 1,80 | 16 |
| 9,5/13,2 | 1,50 | 12 |
| 6,7/9,5 | 1,20 | 8 |
| 4,75/6,7 | 0,90 | 6 |

Menaxheri i Projektit do te percaktoje perqindjet reale te aplikimit ne varesi te rezultateve te seksioneve prove.

Per veshje te dyfishte, do te perdoren perqindjet e meposhtme nominale (tabela 5) per qellime tenderimi:

Tabela 5

| Masa nominale d/D mm | Vlerat nominale te aplikimit | |
|----------------------|--------------------------------------|-----------------------------|
| | Emulsioni bituminoz 1/m ² | Granile kgs/ m ² |
| 13,2/19,0 | 1.2 | 14 |
| 6,7/9,5 | 1 | 9 |

Menaxheri i Projektit do te percaktoje perqindjet reale te aplikimit ne varesi te rezultateve te seksioneve prove.

Ne cdo zone qe do te kete mangesi granilesh do te shtohet material ne menyre te tille qe shtresa perfundimtare te jete nje shtrese e vetme granilesh nga njera bankine tek tjetra.

Eshte e rendesishme te garantohet qe eshte aplikuar vetem nje shtrese granilesh dhe do te kushtohet kujdes ne shmangien e mbishtrimeve te granileve.

Kontaktori do te heqe cdo material te thyer brenda nje jave nga data e aplikimit, duke e pastruar vendin me fshese ose thithese me vakum dhe materialet e thyera dhe te mbledhura te transportohen nga kantieri.

Siperfaqja e perfunduar do te nderthuret mire dhe te kete pamje uniforme pa asnje shenje te rrotave te rrulit.

Te gjitha granilet e ndotura me vaj, karburant apo lubrifikante te tjera duhet te hiqen dhe te zevendesohen me granile te pastra.

e) Makinerite

Duhet te perdoren makinerite e meposhtme ose ekuivalentet e tyre te miratuara:

Makineri shperndarese (bitumatrice): Furnizimi, mirembajtja dhe operimi i makinerise shperndarese te asfaltit per shtrimin e materialit asfaltik ne menyre dhe me presion uniform si dhe me nje devijim te lejueshem nga cdo perqindje e specifikuar. Makineria shperndarese duhet te jete e pajisur me ngrohës, takometer, mjete te matjes se presionit, rezervuar te kalibruar, termometer per matjen e temperatures se permbajtjes se rezervuarit, njesi elektrike per pompen dhe me sprucator te pershtatshme vertikalisht dhe horizontalisht.

Fshese: Nje kompresor rrotullues ose fshese me korrent.

Rrula: Nje (ose disa) rrul pneumatik, vete-levizes, me goma, me ngarkesa te medha ose sipas udhezimeve te Menaxherit te Projektit.

Per rrulat pneumatik me rrota mund te specifikohen edhe presioni i rrotes ose kontaktit.

Shperndares granilesh: Nje shperndares granilesh vete-levizes i nje modeli te miratuar me te pakten 4 rrota dhe e pajisur me goma pneumatike ne dy akset.

Numri i kalimeve duhet te percaktohet pas rezultateve te seksionit prove dhe nga udhezimet e Menaxherit te Projektit.

1205 ASFALTIMI ME PENETRIM DHE ASFALTI I PARAPERGATITUR

Ky seksion mbulon aplikimin e asfaltimit me penetrim ose me asfalt te parapergatitur te gropave te pergatitura.

Gropat duhet te priten me forme dhe me ane.

Kjo pune do te konsistoje ne furnizimin dhe aplikimin e prajmerit dhe emulsionit bituminoz dhe makadamit ose te asfaltit te parapergatitur ne gropat e pergatitura dhe te miratuara me pare.

Do te aplikohen Specifikimet ne Pjesen I (1205).

Shkalla e ngjeshjes nuk do te matet. Numri i kalimeve te percaktuara pas nje seksioni prove (duke marre parasysh 98 % te Proktorit te modifikuar) do te konsiderohen per kontroll.

Aty ku nuk perdoren do rruat e specifikuar, ngjeshja do te kryhet me pajisje ngjeshese krahu ose me rrula te vegjel vibrues te miratuar me pare.

a) Granilet

Te gjitha granilet e perdorura ne perzierjet bituminoze duhet te jete lara mire para se te perdoren per shtrimin e rrugeve. Granilet e trasha dhe te imeta duhet te jete te pastra dhe te mos permbajne asnje lloj materiali te dekompozuar, bimor apo substance tjeter shkaterruese.

Per perzierjet e shtreses konsumuese do te perdoren granile me origjine vullkanike me vlere maksimale konsumimi te Los Angeles 25.

b) Fileri / materiali i imet

Menaxheri i Projektit mund te urdheroje perdorimin e filerit aktiv per te permiresuar parametrat lidhes te granileve. Fileri aktiv do te konsistoje ne hi furnaje, gelqere te hidratuar, cemento Portland, cemento te djegur Portland, hi (zjarri) ose nje perzierje e materialeve te siperpermendura. Fileri aktiv duhet te perputhet me kerkesat e tabelës 6.

Tabela 6

| | |
|--|-----------|
| Intesia qe kalon ne 0,075 mm ne kalim / sitje masive | Min 70 % |
| Poret ne filerin e ngjeshur e te thate | 0.3-0.5 % |
| Permbajtja e ujit | Max. 2% |

Shtimi i pluhurit nga mbledhesi i pluhurit nuk lejohet ne shtresen konsumuese.

c) Bitumi

Lloji i zakonshem i binderit eshte 60/80. Kontraktori mund te propozoje nje lloje tjeter bitumi ne varesi te miratimit te Menaxherit te Projektit. Testet e kerkuara per penetrimin e bitumit 60/80 jepen ne tabelen 7.

Kerkesa per permiresimin e lidhjes se bitumit me granilet do te percaktohet gjate studimeve paraprake, ne varesi te cilesise se bitumit dhe natyres se granileve. Ne qofte se do te jete e nevojshme bitumit duhet t'i shtohet ajente kunder zhveshjes.

Tabela 7

| Prova | Kerkesa |
|---------------------------|----------------|
| Penetrim ne 25 C, 1/10 mm | 60 to 80 |
| Pika e zbutjes, C | 48 to 55 |
| Elasticiteti ne 5 C, cm | > 4 |

| | |
|--------------------------------------|---------|
| Elasticiteti ne 25 C,cm | > 100 |
| Pika e thyrjes, C | < -13 |
| Shperberja,% | > 99 |
| Permbajtja e Parafines,% | < 2 |
| Densiteti ne 15 C,gr/cm ³ | > 0.995 |
| Lidhshmeria me granilet | > 80 |

1205.2 PERBERJA E PERZIERJEVE ASFALTIKE

Perqindjet e aplikimit dhe proporcioneve te perzierjeve te asfaltit qe jepen me poshte jane perqindje dhe proporcione nominale dhe do te perdoren vetem per qellime tenderimi.

Proporcionet nominale te perzierjes by mass te asfaltit jepen ne tabelat 8 dhe 9 per binderin dhe shtresen konsumuese perkatesisht.

Kontraktori duhet t'i paraqese Menaxherit te Projektit, te pakten tete jave para prodhimit ose furnizimit te asfaltit, kampionet e granileve, materialit mbushesh dhe lidheshve bituminoze qe propozon per t'i perdorur sebashku me provat e perzierjes perفشire procedurat e kontrollit te cilesise dhe me kerkesen per miratim.

Tabela 8 (Shtresat Baze dhe Binder)

| Madhesia e sites (mm) | Gjysem i fraksionuar | | Fraksioni i vazhdueshem | | Asfalto beton i dendur |
|--------------------------|----------------------|-------------|-------------------------|-------------|------------------------|
| | 37,5 mm max | 26,5 mm max | 37,5 mm max | 26,5 mm max | |
| 53 | - | - | - | - | 100 |
| 37.5 | 100 | - | 100 | - | 85-100 |
| 26.5 | 85-100 | 100 | 84-94 | 100 | 69-93 |
| 19 | 75-95 | 92-100 | 71-84 | 85-95 | 62-84 |
| 13.2 | | 82-93 | | 71-86 | 53-73 |
| 9.5 | 60-80 | 72-87 | 50-67 | 62-78 | 47-67 |
| 6.7 | | 60-75 | | | 40-60 |
| 4.75 | 45-60 | 60-64 | 36-53 | 42-60 | 34-53 |
| 2.36 | 40-52 | 40-52 | 25-42 | 30-48 | 24-40 |
| 1.18 | 36-47 | 36-47 | 17-34 | 22-38 | 15-30 |
| 0.6 | 32-42 | 32-42 | | 16-28 | 8-21 |
| 0.3 | 22-35 | 22-35 | 10-22 | 12-20 | 3-14 |
| 0.15 | 10-20 | 10-20 | | 8-15 | |
| 0.075 | 4-10 | 4-10 | 5-12 | 5-10 | 2-8 |

| Madhesia e sites | Gjysem i fraksionuar | Fraksioni i vazhdueshem | Asfalt beton i dendur |
|------------------|----------------------|-------------------------|-----------------------|
| Granilet | 93% | 94.5% | 95% |
| Bitum 60/80 | 6% | 5% | 4.5% |
| Fileri aktiv | 1% | 0.5% | 0.5% |

Tabela 9 (Shtresa konsumuese)

| Nr. | Gjysem i fraksionuar | | Fraksioni i vazhdueshem | | |
|-------|----------------------|-----------|-------------------------|--------|-------|
| | 26,5 mm max | 19 mm max | Trashe | Mesme | Fine |
| 26.5 | 100 | | | | |
| 19 | 92-100 | 100 | 100 | | |
| 13.2 | 82-93 | 82-100 | 85-100 | 100 | |
| 9.5 | 72-87 | 73-86 | 71-84 | 82-100 | 100 |
| 4.74 | 50-64 | 45-60 | 62-76 | 54-75 | 64-88 |
| 2.36 | 40-52 | 40-52 | 42-60 | 38-57 | |
| 1.18 | 36-47 | 36-47 | 30-48 | 27-42 | 35-54 |
| 0.6 | 32-42 | 32-42 | 22-38 | 18-32 | 24-40 |
| 0.3 | 22-35 | 22-35 | 16-28 | 13-23 | 16-28 |
| 0.15 | | | | | |
| 0.075 | | | | | |

| | | | | | |
|----------|--------|-------|-------|------|------|
| Agregati | 92.5 % | 92.5% | 93.5% | 93% | 93% |
| Bitumi | 6.5% | 6.5% | 5.5% | 6% | 6% |
| Fileri | 1.0% | 1.0% | 1.0% | 1.0% | 1.0% |

1205.3 Makinerite dhe Fabrikat

Te gjitha fabrikat dhe makinerite e perdorura duhet te kene kapacitet te mjaftueshem, te jene ne gjendje te mire pune dhe duhet te miratohen nga Menaxheri i Projektit.

- **Fabrika:** Fabrika duhet te jete automatikisht e kontrolluar.
- **Makineria shperndarese:** Perzierja duhet te shtrohet me shperndares mekanik vete-levizes dhe asfaltoshtruese te afta per te shtruar ne gjerese, trashesite, pjerresite terthore te kerkuara, pa shkaktuar zgavra ose difekte te tjera mbi siperfaqe.
- Asfaltoshtruesja duhet te furnizohet ne nje menyre te tille qe te mos ndaloje asnjehere per mungese asfalti, deri ne perfundim te seksionit.
- **Rrulat:** Ngjeshja duhet te behet sic specifikohet ne piken 1206.4 te ketyre specifikimeve duke perdorur makinerite e miratuara.
- **Shperndaresit e binderit:** Shperndaresit e binderit te perdorura per shtrimin e binderit bituminoz nuk duhet te kene asnje lloj rrjedhjeje karburanti apo

- binderi dhe duhet te kete helikat per ndarjen e ketyre te fundit, si dhe nje sprucator me kokat sperkatese ne te njejtin kend me shufren mbajttese.
- **Automjetet:** Asfalti duhet te transportohet nga fabrika per tek shtruesja ne kamiona me karroceri te paster, lemuar dhe te mbyllur mire dhe me ane te trajtuara me pare per parandalimin e ngjitjes se perzierjes ne kamion.

1205.4 Kerkesat per siperfaqen

Siperfaqja duhet te fshihet dhe te pastrohet nga te gjitha materialet e lira dhe shkaterruese para aplikimit te emulsionit bituminoz (aty ku ka) dhe para aplikimit te asfaltit gjithashtu. Kontraktori duhet te propozoje makinerite qe duhet te perdoren dhe te marre miratimin e Menaxherit te Projektit.

Aty ku eshte demtuar prajmeri (nese ka), siperfaqja do te riparohet me lyerje me furce dore ose me sperkatje me prajmer te pjeseve te demtuara.

1205.5 Prajmeri dhe emulsioni bituminoz

Prajmeri duhet te aplikohet si ne piken 1204 (a).

Emulsioni bituminoz duhet te aplikohet si ne piken 1204 (b) dhe mbi siperfaqet qe duhen shtruar.

Emulsioni bituminoz duhet te perbehet nga nje emulsion me cilesi te qendrushme te holluar dhe te permbaje 30 % bitum dhe duhet te aplikohet ne nje perqindje prej 0,55 l/m² ose sic udhezohet nga Menaxheri i Projektit.

Emulsioni bituminoz nuk duhet te aplikohen me shume se 24 ore para asfaltit.

Para fillimit te punes, duhet te kontrollohet gjendja e prajmerit. Kurimi i prajmerit duhet te jete i perfunduar.

1205.6 Kushtet atmosferike

Asfalti mund te prodhohet dhe te shtrohet vetem ne kushte te favorshme atmosferike, dhe nuk duhet te prodhohet apo shtrohet kur parashikohet te bjere shi apo ne kushte lageshtire apo mjegulle.

Nuk lejohet asnje punim asfalti kur temperatura e ajrit eshte me pak se 6 ° C.

Temperatura gjate shtrimit dhe ngjeshjes duhet te jete sic kerkohet ne tabelen 10 me poshte.

Tabela 10

| Lloji i binderit | Temperatura minimale e shtrimit °C | | Temperatura minimale e ngjeshjes °C | | | |
|------------------|------------------------------------|-----------------|-------------------------------------|-----------------|--------------|-----------------|
| | Baze asfalti | Shtrese asfalti | Fillimi | | Fundi | |
| | | | Baze asfalti | Shtrese asfalti | Baze asfalti | Shtrese asfalti |
| D60/80 | 140 | 145 | 130 | 140 | 100 | 110 |

Temperatura e perzierjes duhet te kontrollohet ne bunkerin e shtruses.

1205.7 Ngjeshja

Perzierja duhet te rrulohet sa me shpejt te jete e mundur pas shtrimit me rrula me rrota celiku dhe me goma pneumatike ne nje sekuence te parapercaktuar dhe te miratuar gjate shtrimit.

Metoda e ngjeshjes duhet te propozohet nga Kontraktori dhe te miratohet nga Menaxheri i Projektit pas testeve te kalibrimit gjate dites se pare te shtrimit. Keto teste kalibrimi duhet te kryhen si pergjegjesi e Kontraktorit. Ne perputhje me shqyrtimet paraprake te testeve, Kontraktori do t'i propozoje Menaxherit te Projektit:

- Kapacitetin dhe detajet e tjera specifike te te gjitha makinerive;
- Programin e punes te te gjitha makinerive per te garantuar nje numer te kerkuar kalimesh;
- Shpejtesine e te gjitha makinerive;
- Presionin e gomave (kjo mund te varioje nga 3 deri ne 9 bar);
- Temperaturen e shtrimit e cila nuk do te jete me pak se minimalja e dhene ne keto specifikime.

Metoda e propozuar do te konsiderohet si e kenaqshme nese densiteti Marshall i perftuar gjate provave eshte me i larte se 98% e densitetit Marshall te perftuar nga provat e perberjes se perzierjes e cila duhet te miratohet nga Menaxheri i Projektit. Gjate periudhes ndertimore frekuenca e testeve do te jete nje karrote per 250 m rruge ose sipas udhezimeve te Menaxherit te Projektit.

Numri i rrulave qe do te sigurohen duhet te jete ne perputhje me numrim e makinerive shtruese dhe me ate te skuadrave punetore qe propozohen.

Ngjeshja e asfaltit duhet te behet ne nje menyre te tille qe te perftohen vlerat optimale te karakteristikave fizike dhe mekanike te siperfaqes dhe deformimeve.

Ngjeshja duhet te behet pergjate vijes se rruges, nga anet per ne aks; ne seksionet me pjerresi apo me renie terthore, ky operaion do te kryhet nga ana me e ulet tek ajo me e larta.

Rrulat duhet te operojne ngadale, pa shkeputje, ne menyre qe te shmangin valezimet e shtreses.

Siperfaqja e shtreses duhet te kontrollohet vazhdimisht dhe cdo lloj valezimi i lehte duhet te korrigjohet ne te gjitha gjeresine, pas kalimit te pare te rrulit.

Kur ndertohen shtresa te njepasnjeshme, shtrimi dhe ngjeshja duhet te kryhen ne vecanti per secilen shtrese. Per te siguruar nje lidhje te mire midis shtresave, shtresa e siperme duhet te aplikohet brenda 24 oresh nga aplikimi i shtreses se pare dhe siperfaqja e shtreses se pare duhet te jete e paster dhe e thate.

Rrulat e ngjeshjes duhet te pajisen me perparese mbrojtese. Ata nuk duhet te jene asnjehere me shume se 50 m pas shtruses.

Kur distanca e transportit i kalon 10 km ne mot me shi, ngarkesat duhet te mbuloohen me tenda te padepertueshme nga uji ose me flete metalike.

Cdo sasi asfalti qe do te laget nga shiu, apo ndonje shkak tjeter, do te refuzohet. Nuk lejohet transportimi mbi siperfaqe te shtruara rishtaz.

1205.8 Tolerancat

Granulometria e granileve natyrale, per cdo lloj asfalti, duhet te jete brenda limiteve te Specifikimeve qe jepen ne tabelat 8 dhe 9. Ne baze te granulometrise se pergjithshme, e cila propozohet nga Kontraktori ne provat e perzierjes, Kontraktori do te jape qarte limitet e receptures. Limitet e receptures do te llogariten nga granulometria e provave te propozuara me aplikimin e tolerancave te lejueshme per nje test te vetem (shih tabelen 11). Receptura duhet te aplikohet ne procesin e prodhimit, vleresimit dhe kontrollit te asfaltit. Receptura eshte granulometria specifike objektive qe duhet te arrije Kontraktori gjate prodhimit. Megjithate, ne qofte se aplikimi i tolerancave te receptures rezulton ne nje grup granulometrie jashte specifikimeve, do te aplikohen limitet e imponuara nga Specifikimet. Cdo devijim jashte receptures duhet te shqyrtohet dhe te korrigohet shkaku i devijimit. Receptura do te rishikohet, me miratimin e Menaxherit te Projektit, nese do te jete e nevojshme.

Tabela 11

| <i>TOLERANCAT E LEJUESHME</i> | |
|-------------------------------|-------|
| Per > 1.18 mm | 4.00% |
| Per 0,60 mm | 3.00% |
| Per 0,15 mm | 2.00% |
| Per 0,075 mm | 1.50% |
| Permbajtja e bitumit | 0.30% |

Permbajtja optimale e bitumit do te percaktohet nga studimet paraprake laboratorike Marshall. Permbajtja e bitumit do te percaktohet grafikisht, d.m.th. duke perdorur grafiqe te vecanta per qendrueshmerine, fluksin, peshen njesi te perzierjes totale, VIM, VFB dhe VMA. Si pike fillimi, sugjerohet perzgjedhja e asaj permbajtje asfalti me perqindjen mesatare te poreve dhe te kontrollohet nese permbushen te gjitha kriteret.

Prodhimi duhet te kontrollohet cdo dite dhe testet e kerkuara duhet te behen ne cdo 400 t.

Trashesite e shtresave duhet te jete ajo qe jepet ne projekt ose sipas udhezimit te Menaxherit e Projektit.

Limiti i devijimit lokal te trashesise per secilen shtrese te vecante eshte -10%.

Devijimet, te cilat rrisin trashesine nuk konsiderohen per refuzim.

Gjeresite e shtresave duhet te jete ajo qe jepet ne projekt ose sipas udhezimit te Menaxherit te Projektit. Limiti i lejueshem i devijimit lokal do te jete ± 5 cm.

Limiti i lejueshem i devijimit te renies terthore eshte ± 0.4 %.

Per kuotat e profilit gjatesor, lejohen devijimet lokale te meposhtme:

- ± 2.5 cm per shtresen baze dhe ate mbajtese;
- ± 1.5 cm per binderin dhe shtresen konsumuese.

Valezimi i lejueshem ne nje seksion 3 m te drejte eshte 5 mm per shtresen konsumuese.

Shkalla e ngjeshjes nuk do te matet. Numri i kalimeve te percaktuara pas nje seksioni prove (duke marre parasysh 98 % te Proktorit te modifikuar) do te konsiderohen per kontroll.

Aty ku nuk perdoren do rrulat e specifikuar, ngjeshja do te kryhet me pajisje ngjeshese krahu ose me rrula te vegjel vibrues te miratuar me pare.

1206 MAKADAMI I LIDHUR ME UJE

Ky seksion mbulon aplikimin e makadamit te lidhur me uje ne gropat e pergatitura per te formuar shtresen baze te rruges.

Gropat duhet te priten me forme dhe me ane.

Materialet duhet te merren nga burime te miratuara. Menaxheri i Projektit duhet te miratoje rezultatet e testeve.

Trashesia maksimale e ngjeshur e cdo shtrese do te jete 20cm, vetem nqs lejohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit. Duhet te aplikohet frekuenca e kerkuar ne Pjesen I te ketyre specifikimeve.

Shkalla e ngjeshjes duhet te jete 97 % e densitetit te Proktorit te modifikuar. Indeksi i plasticitetit duhet te jete maksimalisht 6 %.

1207 MATERIALET GRANULARE

Ky seksion mbulon furnizimin dhe vendosjen e materialeve te pershtatshme granulare dhe zhavorr ne gropat e pergatitura ose ne bankina. Gropat duhet te priten me forme dhe me ane.

Materiali granular ose zhavorri duhet te merret nga burimet e miratuara ne zonat e prodhimit ose prerjet ne perputhje me piken 1202 (a dhe b), e ketyre specifikimeve.

Vlera maksimale e Los Angeles duhet te jete 45. Densiteti minimal i tharjes ne object duhet te jete 97 % e densitetit te Proktorit te modifikuar.

1208 LLACI I BETONIT

Llaci i betonit do te perzihet ne proporcionet 1:3, me krah ose ne menyre mekanike deri sa te behen uniforme ngjyra dhe permbajtja e tij. Materialet perberese duhet te dozohen saktesisht, duke patur mundesi te grumbullimit te reres. Llaci duhet te behet ne sasi te vogla vetem ashtu sic dhe kur kerkohe nga Menaxheri i Projektit. Llaci, i

cili ka filluar te forcohet apo qe eshte perzier per nje periudhe me te gjate se koha e nevojshme e forcimit te cimentos, nuk duhet te perdoret.

1209 RIPARIMET E STRUKTURAVE TE BETONIT

Ky seksion mbulon riparimet e vogla te strukturave te betoni me beton Marka B20 ose sipas udhezimeve te Menaxherit te Projektit.

Per betonin Marka B20, karakteristika e forces se thyerjes se betonit duhet te jete 20 Mpa.

a) Materialet

Cementoja e perdorur per beton do te jete njera nga te meposhtmet:

- CIMENTO PORTLAND CEMENT OSE CIMENTO PORTLAND ME FORTESIM TE SHPEJTE;

- Cimento Portland e djegur ne furre;
- Cimento Portland 15 ose cimento Portland 15 me fortesim te shpejte.

Menaxheri i Projektit mund te sugjeroje perdorimin e llojeve te tjera te cimentos.

Cimentoja e depozituar ne Objekt duhet te mbahet e mbuluar e cila siguron mbrojtjen e mjaftueshme ndaj lageshtires dhe faktoreve te tjere, te cilet mund te bejne degradimin e cimentos.

Kur cimentoja furnizohet me thase, thaset duhet te rradhiten mire dhe ngushte ne nje grumbull prej jo me shume se 12 thase njeri mbi tjetrin dhe te sistemuara ne menyre te atille qe te mos kene kontakt me token ose mure dhe te mund te perdoren sipas rradhes se furnizimit te tyre ne object.

Kapaciteti i depozites dhe sasia e cimentos se depozituar duhet te jene te mjaftueshme per te mos patur nderprerje te ecurise se punimeve nga mungesa e saj.

Mund te perdoren edhe inertet e trasha dhe ato te imeta. Inertet me madhesi te ndryshme nominale duhet te depozitohen te ndara nga njera tjetra dhe ne nje menyre te tille qe te shmanget petezimi. Duhet te shmanget ndotja nga agjente te huaj.

Uji duhet te jete i paster dhe te mos kete perberes shkaterrues, acide, bazike dhe substanca te tjera organike dhe kimike. Uji i perdorur duhet te jete i pershtatshem per beton, llac dhe kurim.

b) Perzierja

Perberja e betonit te propozuar percaktohet ne baze te testeve paraprake qe perdorin materialet e furnizuara, te bera dhe te testuara nga nje laborator i autorizuar.

Betoni duhet te perzihet ne nje fabrike betoni te certifikuar ose ne Objekt me miratimin e Menaxherit te Projektit.

Lageshtia e inerteve duhet te kontrollohet cdo dite dhe pas cdo ndryshimi ne kushtet atmosferike.

Gjate derdhjes, duhet te sigurohet qe betoni mbush te gjithe kallepin dhe nuk mbetet asnje pore. Betoni i perzier, i cili normalisht duhet te kete temperaturen e derdhjes midis 5-30°C, duhet te derdhet ne kallep brenda maksimumi 1 ore ne rastet e perdorimit te cimentove normale dhe brenda ½ ore ne rastet e perdorimit te cimentove qe fortesohen shpejt. Kur betoni hidhet ne temperatura me te larta se 30°C, duhet te merren masa shtese, si perfshirja e aditiveve per fortesim te ngadalte.

Periodha e perzierjes per materialet duhet te jete 90 sekonda dhe ajo mund te ulet nese Menaxheri i Projektit mendon se ulja e kohes se perzierjes do te prodhoje beton me te njejten fortesi dhe uniformitet si ai i perzier per 90 sekonda.

c) Vendosja dhe Ngjeshja

Para se te hidhet betoni, strukturat e pergatitura duhet te jene te pastra dhe te lagura me uje. Sapo te filloje derdhja e betonit, ai duhet te vendoset Brenda 30 minutash nga koha e perfundimit te perzierjes dhe Brenda 90 minutash nga koha e fillimit te perzierjes. Menaxheri i Projektit mund te zgjase keto kohe kur perdoret nje perzierje me fortesim te ngadalte. Betoni nuk duhet te hidhet ne asnje pjese te Punimeve deri sa te jepet miratimi i Menaxherit te Projektit.

Betoni duhet te jete pershtatshmerisht i punueshem, pa teprica uji ne menyre qe te mund te ngjshet lehte ne qoshet e kallepeve dhe perreth armimit pa krijuar shtresezime dhe zgavra.

Per ngjeshjen e betonit, duhet te perdoren mjetet e meposhtme mekanike: vibratore, kallepe vibrues, tavolina vibruese. Gjate ngjeshjes se betonit te sapo hedhur duhet patur kujdes ndaj zhvendosjeve te armimit dhe kallepeve.

1. Trajtimi

Betoni do te mbrohet nga demet e shkaktuara nga kushtet atmosferike dhe klimaterike.

Betoni duhet te mbahet i lagur ne siperfaqet e ekspozuara per te pakten shtate dite pas derdhjes.

Menjehere pas derdhjes, dhe per 7 dite me rradhe, betoni duhet te mbrohet nga efektet demtuese atmosferike. Menaxheri I Projektit do te miratoje metodat e mbrojtjes.

2. Pranimi

Kontraktori do te perballoje kostot e testeve te kerkuara. Kontraktori duhet te siguroje nje certificate cilesie dhe Menaxheri i Projektit do te beje inspektimin rutine.

Testet duhet te kryhen ne laborator te autorizuar dhe te miratuar.

1210 DITEPUNE

Çdo aktivitet punimesh që nevojitet me urgjence, dhe nuk është listuar ne preventiv dhe që specifikohen ketu si punime emergjence, riparim strukturash per te parandaluar prishjen e metejshme te tyre duhet të kryhen mbi bazen e diteve të punes duke

angazhuar fuqi punetore dhe paisje, nese nevojitet. Menaxheri i Projektit do të udhezaje me shkrim kryerjen e ketyre punimeve para se Kontraktori të mund të kryeje matjet individuale. Ne të tilla raste, koha e fuqise punetore dhe paisjeve e harxhuar per matjen e dites se punes duhet të regjistrohet ne tabela të vecanta per ditet e punes të pergatitura dhe të firmosura nga Kontraktori dhe duhet të aprovohen dhe të firmosen gjithashtu nga Menaxheri i Projektit.

Cmimi per ore pune i çdo punetori si dhe per mbikqyresin duhet të përfshije të gjitha kostot e listuara ne Parathenien e Preventivit dhe duhet të përfshije të gjitha veglat dhe paisjet e perdorura gjate kryerjes se punimeve. E njejta gje i referohet edhe automjeteve dhe paisjeve kryesore, shpenzimeve per karburant, lubrifikante, pjese kembimi, riparime dhe zhvleresimin e parase si dhe rrogave të shofereve, operatoreve dhe ndihmesve që gjithashtu duhet të përfshihen ne cmimet per ore. Materialet e perdorura gjate kryerjes se matjeve të punes ditore duhet të rregjistrohen dhe listohen; ato duhet të perdoren ne menyren me ekonomike dhe profesionale per të parandaluar çdo humbje apo keqperdorim.

1212 Sigurimi dhe zevendesimi i mbrojteseve metalike (guardrail)

Ky ze punimi mbulon cmontimin e mbrojteseve metalik te demtuar dhe zevendesimin e tyre ne cilesin dhe tipin e asaj ekzistuese. Ky punim duhet te kryhet me mjetet dhe fuqine punetore te kontraktorit. Menaxheri i Projektit do te udhezaje me shkrim kryerjen e ketyre punimeve para se kontraktori te munde te kryej matjet individuale.

Vendosja e mbrojteseve metalike (guardrail) behet me cekic pneumatik (batipal special).

Materiale qe do te perdoren duhet te jene te certifikuara dhe te miratuara nga Menaxheri i Projektit.

Gjate vendosjes se guardrejlit te ruhet lineariteti i rruges sipas planimetrise se saj.

Menyra e vndosjes percaktohet sipas standarteve dhe do te jepen nga Menaxheri i Projektit.

1300 METODA E PAGESES DHE E PERSHKRIMIT

Zeri 1.1

Ky perfshin:

- Vendosja brenda nje jave, e nje kampi ne afersi te kantierit, me te gjitha facilitetet per pritje.
- Ruajtja, ndricimi, kontrolli i trafikut, duke perfshire dhe shenjatat e trafikut, si tregohet ne Planin e Manaxhimit te Trafikut dhe ruajtja e punimeve gjate gjithes kohes.
- Vendosja ne pritje e nje stafi te kualifikuar te kontraktorit dhe te faciliteteve komunikuese,
- Veshjet e shiut dhe xhaketat reflektuese per te gjithes punetoret.
- Prezenca e perhershme (nga hena ne te premte perfhire dhe ditet e festave), gjate gjithes periudhes se kontrates, e te pakten 1 (nje) puntori per cdo 3 (tre) kilometer, por numri total i punetoreve duhet te jete te pakten tre per te

- realizuar detyrimet e pergjithshme te mirembajtjes.Per ditet e shtune dhe te diela prezenca duhet te paktën 50% e diteve te tjera
- Sigurimi dhe garancite.

Pagesa per zerin 1.1 I pa aplikueshem

Shenim: Aktivitetet e meposhtme, qe lidhen me Punimet Rutine te Faqes 2 (zeri 2.1 deri ne zerin2.9)dhe te faqes 3 te Preventivit (3.1, 3.4, 3.5, 3.6, 3.7, 3.8, 3.9, 3.10, 3.11, 3.12, 3.13, 3.14, 3.15), duhet te perseriten, nqs eshte e nevojshme, si do instruktohet nga Manaxheri Projektit ne Programet mujore te punimve, gjate gjithe periudhes se kontrates, pa shtese ne pagese.

Zeri 2.1

Pastrim i kanaleve anesore te kullimit.

Ky pershkrim aplikohet per pastrimin e kanaleve ose kunetave anesore deri ne drejtimin dhe kuoten fillestare, ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

- Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetore;
- Pastrimin nga gjethet, deget dhe etj.;
- Mbushjen e hapesirave pas shkuljes me dhë te pershtatshem dhe ngjeshjen e tyre;
- Germimin dhe transportimin e materialeve perfshire mjetet e transportit;
- Depozitimin e materialeve jashte Zones ne Pronesi te Rruges ne nje vend te propozuar nga Kontraktori ne perputhje me kushtet e kerkuara ne Planin e Menaxhimit te Mjedisit (P.M.M.);
- Depozitimin ne zona te vecanta te percaktuara nga Menaxheri i Projektit te materialeve te pershtatshme me ato te papershtatshmet;
- Sistemin e siperfaqes te depozitimeve pas perfundimit te Punimeve ne perputhje me (P.M.M.);
- Matjen topografike dhe nivelimin.

Pagesa per pastrimin e kanaleve anesore te kullimit deri ne drejtimin dhe kuoten fillestare do te behet per muaj (Muaj) sic pershkruhet me siper.

Zeri 2.2

Nuk perdoret

Zeri 2.3

Pastrim i tombinove rrethore dhe katrore ekzistuese.

Ky pershkrim aplikohet per pastrimin e tombinove rrethore dhe katrore ekzistuese nga mbetjet sedimente apo bimet dhe prurjet e ngurta te depozituara me cfaredolloj mjete te mundshem, ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

- Identifikimin e tombinos rrethore dhe katrore qe duhet pastruar dhe paraqitjen e propozimit tek Menaxheri i Projektit;
- Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetore;
- Pastrimin e prurjeve;
- Transportimin e materialeve te hequra perfshire mjetet e transportit;
- Depozitimin e materialeve jashte Zones ne Pronesi te Rruges ne nje vend te propozuar nga Kontraktori dhe ne perputhje me kushtet e kerkuara ne Planin e Menaxhimit te Mjedisit (P.M.M.);
- Sistemimin e siperfaqes se depozitimeve pas perfundimit te punimeve ne perputhje me (P.M.M.).

Pagesa per pastrimin e tombinove rrethore e katrore ekzistuese do te behet per muaj sic pershkruhet me siper.

Zeri 2.4

Nuk perdoret

Zeri 2.5

Nuk do perdoret

Zeri 2.6

Nuk do perdoret.

Zeri 2.7

Nivelim me greider i bankinave dhe mbushjeve ne drejtimin dhe kuoten e percaktuar nga Menaxheri i Projektit.

Ky pershkrim aplikohet per nivelimin me greider te bankinave dhe mbushjeve ne drejtim dhe kuote, ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

- Kryerjen e Punimeve vetem me miratimin me shkrim te Menaxherit te Projektit;
- Firmosjen e programimit te kohes nga Menaxheri i Projektit dhe Kontraktori;
- Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetorise;
- Transportimin e materialeve perfshire mjetet e transportit;
- Depozitimin e materialeve jashte Zones ne Pronesi te Rruges ne nje vend te propozuar nga Kontraktori dhe ne perputhje me kushtet e kerkuara ne Planin e Menaxhimit te Mjedisit;
- Sistemimin e siperfaqes se depozitimeve pas perfundimit te Punimeve ne perputhje me (P.M.M.);
- Matjen topografike dhe nivelimin.

Pagesa per nivelimin me greider te bankinave dhe mbushjeve do te behet per muaj sic pershkruhet me siper.

Zeri 2.8

Prerje, shkulje dhe largim nga objekti i bimeve nga anet e rruges.

Ky pershkrim aplikohet per prerjen, shkuljen dhe largimin nga objekti te bimeve ne ane te rruges, ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

- Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetorise;
- Pastrimin e gjetheve, degeve, barit, etj;
- Shkuljen e bimesise se siperfaqes deri ne 5cm thellesi;
- Heqjen e rrenjeve te drunjta ne thellesi me te madhe se 5cm;
- Heqjen dhe transportimin perfshire mjetet e transportit te materialeve ne vendin e caktuar nga Kontraktori dhe te miratuar nga Menaxheri i Projektit dhe ne perputhje me kerkesat e Planit te Menaxhimit te Mjedisit (P.M.M.);
- Mbushjen e hapësirave pas heqjes se rrenjeve;
- Matjen topografike dhe nivelimin.

Pagesa per prerjen, shkuljen dhe largimin nga objekti do te behet per muaj sic pershkruhet me siper.

Zeri 2.9

Pastrimi i rruges nga guret e rene, prurjet dhe rreshqitjet.

Ky pershkrim aplikohet per pastrimin e rruges nga guret e rene, prurjet dhe rrshqitjet, ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

- Identifikimi i siperfaqeve qe do pastrohen;
- Furnizim me materiale, makineri dhe puntori;
- Heqje e gureve dhe prurjeve;
- Transporti qe nenkupton transportin e materialeve.
- Heqjen e materialeve ne vendin e caktuar nga Kontraktori dhe te miratuar nga Menaxheri i Projektit dhe ne perputhje me kerkesat e Planit te Menaxhimit te Mjedisit (P.M.M.);
- Rregullimi i siperfaqes se depozited pas perfundimit te puneve ne perputhje me (P.M.M.).

Pagesa pastrimi i rruges nga guret e rene, prurjet dhe rreshqitjet e dherave do te behet per muaj sic pershkruhet me siper.

Zeri 3.1

Sigurim, shtrim dhe ngjeshje ne gropat tashme te pergatitura e asfaltimit me penetrim ose asfaltit te prodhuar per kete qellim ne fabrika te vecanta.

Ky pershkrim aplikohet per pergatitjen e gropave me forme dhe sprucimin e tyre me prajmer dhe sigurimin dhe shtrimin e asfaltimit me penetrim ose asfaltit te prodhuar ne fabrike te vecante, ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

- Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetore;
- Transportimin e materialeve perfshire mjetet e transportit;
- Prerjen e gropave me forme;
- Pastrimin e siperfaqeve te gropave me ajer me presion te larte;
- Sigurimin dhe spucimin me prajmet te gropave dhe aneve te tyre;
- Sigurimin dhe shtrimin e asfaltimit me penetrim ose te prodhuar ne fabrike te vecante;
- Ngjeshjen;
- Marrjen e kampioneve dhe testimin;
- Matjen topografike dhe nivelimin.

Ne rastet kur moti nuk lejon mbushjen e gropave me asfalt menjehere, atehere kontraktori do ti mbushet ato me material te perkohshem, duke patur parasysh qe rruga duhet te jete pa gropa. Gropat e mbushura ne kete menyre do te rimbushen si duhet sapo te jete e mundur nga moti.

Pagesa per pergatitjen e gropave, sigurimin dhe shtrimin e asfaltimit me penetrim ose te prodhuar ne fabrike do te behet per muaj sic pershkruhet me siper.

Zeri 3.2

Sigurim dhe aplikim i perpunimit siperfaqesor me Dy Duar ne te nxehte.

Ky pershkrim aplikohet per pergatitjen e siperfaqeve me forme dhe sprucimin e tyre me prajmer dhe sigurimin dhe shtrimin e perpunimit siperfaqesor me Dy Duar ne te nxehte ne zonat e cara me granil, ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

- Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetore;
- Transportimin e materialeve perfshire mjetet e transportit dhe heqja;
- Prerjen e siperfaqeve me forme;
- Pastrimin e gropave me ajer me presion te larte;
- Sigurimin dhe sprucimin me prajmer te siperfaqes dhe faqeve te tyre;
- Sigurimin dhe shtrimin e perpunimit siperfaqesor me Dy Duar;
- Ngjeshjen;
- Marrjen e kampioneve dhe testimin;
- Matjen topografike dhe nivelimin.

Pagesa per pergatitjen e gropave, sigurimin dhe shtrimin e perpunimit siperfaqesor me Dy Duar do te behet per meter katror (m2) sic pershkruhet me siper.

Zeri 3.3

Nuk perdoret

Zeri 3.4

Sigurim, shtrim dhe ngjeshje ne gropat tashme te pergatitura e shtreses se makadamt per te krijuar shtresen baze te rruges.

Ky pershkrim aplikohet per pergatitjen e gropave, sigurimin, shtrimin dhe ngjeshjen e Makadamt per te formuar shtresen baze te rruges, ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe kerkesat e Menaxherit te projektit.

Puna perfshin:

1. Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetore;
2. Transportimin e materialeve perfshire mjetet e transportit;
3. Prerjen e gropave;
4. Pastrimin e gropave dhe lagien me uje para hedhjes se materialit;
5. Sigurimin dhe shtrimin e Makadamt te miratuar dhe me granulometrine e duhur;
6. Ngjeshjen;
7. Marrjen e kampioneve dhe testimin;
8. Matjen topografike dhe nivelimin.

Pagesa per pergatitjen e gropave, sigurimin, shtrimin dhe ngjeshjen e Makadamt do te behet per muaj sic pershkruhet me siper.

Zeri 3.5

Sigurim, shtrim dhe ngjeshje ne gropat tashme te pergatitura e zhavorrit/granilit per riparim bankine.

Ky pershkrim aplikohet per pergatitjen e gropave, sigurimin, shtrimin dhe ngjeshjen e zhavorrit/granilit te pershatashem per riparim bankine, ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

1. Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetore;
2. Transportimin e materialeve perfshire mjetet e transportit;
3. Prerjen e gropave;
4. Pastrimin e gropave dhe lagjen me uje para hedhjes se materialit;
5. Sigurimin dhe shtrimin e zhavorrit/granilit te pershtatshem;
6. Ngjeshjen;
7. Marrjen e kampioneve dhe testimin;
8. Matjen topografike dhe nivelimin.

Pagesa per pergatitjen e gropave, sigurimin, shtrimin dhe ngjeshjen e zhavorrit/granilit te pershtatshem do te behet per muaj sic pershkruhet me siper.

Zeri 3.6

Kryerja e riparimeve ne strukturat prej tulle ose guri me llac cemento 1:3.

Ky pershkrim aplikohet per riparimin e strukturave prej tulle ose guri me llac cemento 1:3, ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

1. Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetore;
2. Transportimin e materialeve perfshire mjetet e transportit;
3. Pastrimin para hedhjes se llacit;
4. Sigurimin dhe vendosjen e llacit te cimentos;
5. Matjen topografike dhe nivelimin;
6. Suvatimin;

Pagesa per kryerjen e riparimeve te strukturave prej tulle ose guri do te behet per meter kub (m³) sic pershkruhet me siper.

Zeri 3.7

Kryerja e riparimeve ne strukturat prej betoni.

Ky pershkrim aplikohet per riparimin e strukturave prej betoni me beton, ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

- Furnizimin dhe trajtimin e cimentos, ujit, inerteve dhe te gjitha materialeve te tjera, makinerive dhe punetore;
- Transportimin e materialeve perfshire mjetet e transportit;
- Pastrimin para hedhjes se betonit;
- Pergatitjen, furnizimin derdhjen dhe ngjeshjen e betonit B20;
- Trajtimin e betonit gjate procesit te fortesimit;
- Te gjitha kallepet e nevojshme;
- Montimin dhe cmontimin;
- Pastrimin e objektit pas derdhjes se betonit;
- Marrjen e kampioneve dhe testimin;
- Matjen topografike dhe nivelimin;

Pagesa per kryerjen e riparimeve te strukturave prej betoni do te behet per meter kub (m³) sic pershkruhet me siper.

Zeri 3.8

Sigurimi dhe lyerja me boje te bardhe te aprovuar te shenjave dhe strukturave rrugore

Ky pershkrim aplikohet per sigurimin dhe lyerjen e shenjave gjatesore dhe terthore te pjeses kaluese te rruges, ne perputhje me Specifikimet Teknike, Planin e Menaxhimit te Trafikut dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

- Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetore;
- Furnizimin dhe ngritjen e materialeve te nevojshme si dhe te lyersve dhe mikro-sferave per finalizimin e shenjave por edhe per procedurat parashenjuese.
- Transportimin perfshire mjetet e transportit dhe trajtimin e te gjitha makinerive te nevojshme si dhe pastrimin dhe sinjalizimin e rruges gjate punes;
- Testimin.

Pagesa per sigurim dhe lyerje me boje te bardhe (te miratuar) e shenjave dhe strukturave rrugore behet me m2 (sic shprehet ne preventiv) sic pershkruhet me siper.

Zeri 3.9

Riparim trotuare betoni/ pllaka betoni

Ky pershkrim aplikohet per riparimin e strukturave prej betoni ose pllaka betoni ne trotuare, ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

- Furnizimin dhe trajtimin e cimentos, ujit, inerteve dhe te gjitha materialeve te tjera, makinerive dhe punetore;
- Transportimin e materialeve perfshire mjetet e transportit;
- Pastrimin para hedhjes se betonit ose shtrimit te pllakave te betonit;
- Pergatitjen, furnizimin derdhjen dhe ngjeshjen e betonit B20; ose nivelimin e shtreses se reres perpara vendosjes se pllakave te betonit

- Trajtimin e betonit gjate procesit te fortesimit;
- Te gjitha kallepet e nevojshme;
- Montimin dhe cmontimin;
- Pastrimin e objektit pas derdhjes se betonit;
- Marrjen e kampioneve dhe testimin;
- Matjen topografike dhe nivelimin;

Pagesa per kryerjen e riparimeve te trotuareve prej betoni/ apo me pllaka betoni do te behet per meter katror (m2) sic pershkruhet me siper.

Zeri 3.10

Riparim bordura betoni

Ky pershkrim aplikohet per riparimin e srtukturave prej betoni ne bordura, ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

- Furnizimin dhe trajtimin e cimentos, ujit, inerteve dhe te gjitha materialeve te tjera, makinerive dhe punetorise;
- Transportimin e materialeve perfshire mjetet e transportit;
- Pastrimin para hedhjes se betonit
- Pergatitjen, furnizimin derdhjen dhe ngjeshjen e betonit B20;
- Trajtimin e betonit gjate procesit te fortesimit;
- Te gjitha kallepet e nevojshme;
- Montimin dhe cmontimin;
- Pastrimin e objektit pas derdhjes se betonit;
- Marrjen e kampioneve dhe testimin;
- Matjen topografike dhe nivelimin;

Pagesa per kryerjen e riparimeve te bordurave te betonit do te behet per meter linear (ml) sic pershkruhet me siper.

Zeri 3.11

Riparim puseta + zevendesim kapake pusetash

Ky pershkrim aplikohet per riparimin e pusetave te realizuara me mur tulle apo betone si dhe zevendesimin e kapakeve te pusetave prej betoni apo zgare hekuri

Puna perfshin:

1. Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetorise;
2. Transportimin e materialeve perfshire mjetet e transportit;
3. Prishjen e pusetave te demtuara;
4. Transportin e mbeturinave;
5. Sigurimin e materialeve per realizimin e procesit te punes
6. Marrjen e kampioneve dhe testimin;
7. Matjen topografike dhe nivelimin.

Pagesa per riparimin e pusetave dhe zevendesimin e kapakeve te pusetave do te behet me cope sic pershkruhet me siper.

Zeri 3.12

Riparimi/zevendesimi I sinjalistikes vertikale (tabela +aksesore)

Ky pershkrim aplikohet per riparimin ose zevendesimin e sinjalistikes vertikale ne rruge

Puna perfshin:

1. Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetore;
2. Transportimin e materialeve perfshire mjetet e transportit;
3. Heqjen e sinjalistikes te demtuar
4. Transportin e mbeturinave;
5. Sigurimin e materialeve per realizimin e procesit te punes
6. Marrjen e kampioneve dhe testimin;
7. verifikimine punes se perfunduar.

Pagesa per riparimin apo zevendesimin e sinjalistikes vertikale rrugore do te behet me cope

Zeri 3.13

Riparimi/zevendesimi i shtyllave elektrike dhe llampave ne rruge

Ky pershkrim aplikohet per riparimin ose zevendesimin e shtyllave elektrike dhe llampave te ndricimit ne rruge

Puna perfshin:

1. Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetore;
2. Transportimin e materialeve perfshire mjetet e transportit;
3. Heqjen e sinjalistikes te demtuar
4. Transportin e mbeturinave;
5. Sigurimin e materialeve per realizimin e procesit te punes
6. Marrjen e kampioneve dhe testimin;
7. verifikimine punes se perfunduar.

Pagesa per riparimin apo zevendesimin e shtyllave elektrike dhe llampave ne rruge do te behet me cope

Zeri 3.14

Sigurim dhe lysterje me ngjyrat e pershtatshme te gureve te kilometrazhit, shenjave te drejtimit dhe trafikut.

Ky pershkrim aplikohet per sigurimin dhe aplikimin e lyerjes me ngjyra te pershtatshme, te gureve ekzistues te kilometrazhit, shenjave te drejtimit dhe te trafikut, ne perputhje me Specifikimet Teknike, Planin e Menaxhimit te Trafikut dhe kerkesat e Menaxherit te Projektit.

Puna perfshin:

- Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetore;
- Furnizimin dhe ngritjen e materialeve te nevojshme per lyerjen e gureve te kilometrazhit, shenjave te drejtimit dhe te trafikut ne perputhje me Planin e Menaxhimit te Trafikut;
- Transportimin perfshire mjetet e transportit dhe trajtimin e te gjitha makinerive dhe materialeve te nevojshme;
- Testimin.

Pagesa per Sigurim dhe lyerje me ngjyrat e pershtatshme te gureve te kilometrazhit, shenjave te drejtimit dhe trafikut. do te behet per muaj ose ne m2 (sic shprehet ne preventiv) sic pershkruhet me siper.

Zeri 3.15

Sigurimi dhe zevendesimi i mbrojteseve metalike (guardrail)

Ky pershkrim aplikohet per heqjen dhe zevendesimin e elementeve metalike ne perputhje me specifikimet teknike dhe tipin e mbrojteseve metalike.

Puna perfshin:

- Furnizimin e materialeve, makinerive dhe punetore;
- Montimin dhe c'montimin e paisjeve dhe asesoreve metalik
- Furnizimin dhe ngritjen e materialeve per vendosjen dhe fiksimin e elementeve metalike.
- Marrjen e kampioneve dhe testimin;
- Matjen topografike dhe nivelimin;

Pagesa Sigurimi dhe zevendesimi i mbrojteseve metalike (guardrail) do te behet per ml (sasi) sic pershkruhet me siper.

SHENIME:

- Kontraktori duhet tu referohet VP per Zerat perkates kur perdor pershkrimet e mesiperme dhe ne rastin e punimeve te Paparashikuara sipas udhezimeve te Menaxherit te Projektit.
- Kushtet e kerkuara ne Planin e Menaxhimit te Mjedisit (PMM) jepen ne menyre te permbledhur ne Aneksin 1 te ketyre specifikimeve, te quajtura Plani Lehtesues i Mjedisit.
- Aneksi 1 permban 2 faqe, te cilat nuk jane numeruar

PREVENTIVI

1. Volumet e Punes duhet te lexohen ne lidhje me Kushtet e Kontrates, Specifikimet, Vizatimet dhe Dokumentat e tjera te Kontrates.
2. Pershkrimi i shkurter i zerave ne preventive eshte dhene vetem per identifikim dhe nuk mund te dale mbi pershkrimin e detajuar qe jepet ne kushtet e kontrates dhe specifikimet.
3. Per vendosjen e cmimeve, kontraktori duhet te kryej vete nje inspektim te rruges dhe te percaktoje paraprakisht nevojat e mirembajtjes dhe do ti referohet Kushteve te Kontrates, Specifikimet, Projektit dhe ketij prezantimi te preventivit per nje orientim dhe pershkrim materialesh, puntori, kushtet, detyrimet dhe te perputhet me keto kerkesa, ne zbatimin e kontrates.
4. Sasite e dhena ne preventive jane per pagesa mujore, bazuar ne vleresimet e kontraktorit. Bazat e pagesave do te jene varesi e kryerjes se punimeve te verifikuara nga Manaxheri i Projektit ne fund te cdo muaji sipas kushteve te kontrates.
5. Cmimet e vendosura nga Kontraktori do te perfshijne koston e punimeve te meposhtme, detyrimet dhe shpenzimet e kontraktorit per zerat qe nuk jane dhene vecante ne specifikime dhe preventiv:
 - ♦ Te gjithe detyrimet, rezervat dhe sigurimi do te perfshihen ne faqen 1 te preventivit ne Dokumentat e Kontrates.
 - ♦ Plotesimi strikt i te gjithe specifikimeve. Pershkrimi i punimeve dhe materialeve qe nuk jane ne preventiv.
 - ♦ Ato gjithashtu perfshine te gjitha punimet, ambientet dhe rruget aksese te kerkuara, largimin dhe kthimin e ketyre ne te fundit ne gjendjen e meparshme pas perfundimit te punes, sigurimin e te gjithe miratimeve dhe lejeve ndertimore, zonen ne pronsi te rruges dhe punimet e perkoshme.
6. Cmimet duhet te jepen te gjitha ne LEKE duke perjashtuar TVSH.
7. Perkrahe secilit ze punimesh ne Volumet e Punes duhet te jepet nje cmim njesi, kjo edhe ne rastin kur nuk jepen volumet. Kostot e zerave per te cilat Kontraktori nuk ka dhene nje cmim do te mbulohe me cmimet e tjera te perfshira ne Volumet e Punes. Per cdo ze kontraktori duhet te plotesoje kolonen e "Totalit".
8. Kostoja totale e perputhjes me dispozitat e Kontrates duhet te jepet ne zerat e dhena ne Volumet e Punes, dhe ne rastin kur nuk ka zera specifike, kostoja do te shperndahet ne cmimet e tjera per Zerat perkates te Punimeve.
9. Udhezimet dhe pershkrimet e pergjithshme te punimeve dhe materialeve nuk perseriten apo permblidhen domosdoshmerisht ne Volumet e Punes. Referencat e seksioneve perkatese te Dokumentave te Kontrates duhet te behen para dhenies se cmimeve njesi per zerat e Volumeve te Punes.
10. Gabimet aritmetike do te korrigjohen nga Punedhenesi, sipas Klauzoles perkatese te Udhezimeve per Tenderuesit.

11. Pa ndikuar ne pergjithesimet e kushteve te mesiperme, kuotat dhe cmimet e vendosura nga Kontraktori ne Preventiv duhet te perfshijne koston dhe shpenzimet e meposhteme:
- (a) Sigurimin, depozitim, transportin, perdorimin dhe mirembajtjen e te gjitha materialeve, impianteve, paisjeve, makinerive dhe veglave duke perfshire te gjitha koston, taksat detyrimet e tjera nga ngarkimi apo importimi.
 - (b) Sigurimin dhe mirembajtjen e te gjithe stafit dhe punetoreve si dhe pagesen, akomodimin dhe transportin e tyre dhe kerkesa te tjera perfshire dhe Ndihmen e Pare dhe masat e sigurise.
 - (c) Sigurimin dhe mirembajtjen e devijimeve te perkoheshme te trafikut dhe rregulloreve, pengesave dhe supervizioni.
 - (d) Sigurimin, transportin, perdorimin dhe mirembajtjen e te gjitha rezervave te konsumit, karburantit, ujit, kanaleve kulluese, energjise elektrike, dhe telefonit, perfshi edhe ato qe kerkohen sipas Kontrates nga Menaxheri i Projektit dhe stafi i tij.
 - (e) Shfrytezimi dhe riinstalimi pas plotesimit te karrierve.
 - (f) Asistenca per Supervizorin dhe marrja e kampioneve testimi kontrolli i informacionit te dhene nga Menaxheri i Projektit.
 - (g) Vendosja e sherbimit te sigurise nga perendimi ne lindje per zyra dhe laborator qe perdoret nga Supervizioni dhe stafi i tij.
12. Sasite per cdo ze pune qe do te ekzekutojne Kontraktoret ne perputhje me kontraten do te matet neto dhe nuk do paguhet per hapje, germim, rritje dhe zbritje volumi per shkak te ngjeshjes ose per hapje hapsire pune.
13. Te perfshihen gjithashtu dhe keto zera te cilat nuk jane dhene ne vecanti:
- i) Siguria tafikut dhe kontrolli;
 - ii) Pastrimi, ndertimi, mirembajtje dhe ri-instalim te rrugeve te perkohshme dhe e gjitha veprimet qe lidhen me zhvendosjen e perkohshme te trafikut;
 - iii) Shenjat e trafikut te perkohshem;
 - iv) Mbrojtja e sherbimeve dhe ri-instalimeve te tyre ne raste demtimi;
 - v) Mundesi hyrje;
 - vi) Pastrim dhe plotesim.

LISTA E CMIMEVE

TABELA PERMBLEDHESE

Kontrata _____

| Lista No. | Pershkrimi | Vlera e Kontraktorit | Vlera e Nenktraktorit (nqs ka) | SHUMA (LEK) |
|-------------------------|---|-----------------------------|---------------------------------------|--------------------|
| 2 | Drenazhim dhe Pastrim | | | |
| 3 | Riparime te vogla ne shtresa, bankina dhe struktura | | | |
| Nen - total | | | | |
| 8 | Dite-Pune 3% te cmimit te kontrates [2] | | | |
| SHUMA | | | | |
| T.V.SH 20% | | | | |
| TOTALI I OFERTES | | | | |

[2] Kjo shifer eshte e fiksuar ne 3% te cmimit te kontrates dhe nuk mund te ndryshohet nga kontraktori.

LISTA No.1

Kontrata Nr. _____

Kategoria e Punimeve: NGRITJA E KANTIERIT TE KONTRAKTORIT

| Zeri Nr. | Pershkrimi | Sasia | Njesia | Cmimi | Vlera |
|---|--|-------|--------|-------|-------|
| 0 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 1.1 | <p>Vendosja brenda nje jave, e nje kampi ne afersi te kantierit, me te gjitha facilitetet per pritje.</p> <p>Ruajtja, ndricimi, kontrolli i trafikut, duke perfshire dhe shenjat e trafikut, si tregohet ne Planin e Manaxhimit te Trafikut dhe ruajtja e punimeve gjate gjithse kohes.</p> <p>Vendosja ne pritje e nje stafi te kualifikuar te kontraktorit dhe te faciliteteve komunikuese,</p> <p>Veshjet e shiut dhe xhaketat reflektuese per te gjithse punetoret.</p> <p>Prezenca e perhershme (nga hena ne te premtse perfshire dhe ditet e festave), gjate gjithse periudhes se kontrates, e te pakten 1 (nje) puntori per cdo 3 (tre) kilometer, por numri total i punetoreve¹ duhet te jete te pakten tre per te realizuar detyrimet e pergjithshme te mirembajtjes. Sigurimi dhe garancite. Shih specifikimet teknike perkatese.</p> | | | | |
| Totali i Mbartur ne Tabelen Permbledhese | | | | | |

¹ Puntoret e kerkuar ne kete ze jane thjesht puntoret, dhe jo drejtues makinerish apo stafi i specializuar.

LISTA Nr.2

Kontrata Nr. _____

Kategoria e Punimeve: DRENAZHIM DHE PASTRIM

| Zeri Nr. | Pershkrimi | Njesia | Sasia ne muaj | Sasia km | Cmimi | Vlera |
|---|--|--------|---------------|----------|-------|-------|
| 0 | 1 | 3 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 2.1 | Pastrimi dhe lirimi i kunetave, kanaleve te hapura, K.U.Z .dhe K.U.B. | muaj | 8 | 33 | | |
| 2.3 | Pastrim i tombinove ekzistuese rrethore dhe katrore nga mbetjet, sedimente apo bimet dhe prurjet e ngurta te depozituara (Shiko shenimin me poshte) | muaj | 8 | 33 | | |
| 2.7 | Nivelimi i bankinave dhe mbushjeve ne nivelin fillestar (Shiko shenimin me poshte) | muaj | 8 | 33 | | |
| 2.8 | Prerja, shkulja dhe pastrimi i bimesise se rritur ne zonen e rruges (Shiko shenimin me poshte) | muaj | 8 | 33 | | |
| 2.9 | Pastrimi i karrexhates nga aluvionet (Shiko shenimin me poshte) | muaj | 8 | 33 | | |
| Totali i Mbartur ne Tabelen Permbledhese | | | | | | |

Shenim: Aktivitetet e mesiperme qe kane te bejne me Punimet Rutine te Listes 2 (zerat 2.1 deri ne 2.9) duhet te perseriten, nese eshte e nevojshme, gjate kohezgjatjes se Kontrates (shih Specifikimet, Klauzola 1201 “Qellimi”).

Pagesa mujore, per secilin nga zerat e punimeve, duhet te percaktohet nga Tenderuesit mbeshtetur ne inspektimin e seksioneve rrugore te kesaj kontrate dhe ne vleresimet profesionale te Tenderuesit per nivelet e nevojshme te nderhyrjeve per te mbajtur nivelin e drenimit dhe rrugen ne nivelet e percaktuara ne Specifikimet, Seksioni B.1. Kontraktori duhet te kete ne konsiderate qe pagesa mujore eshte fikse sa ajo e ofruar ne oferte pavarasisht nga niveli i mirembajtjes qe do kerkohet gjate zbatimit te kontrates (shih specifikimet Kaluzola 1201 per Programin mujor te punimeve).

LISTA Nr.3

Kontrata Nr. _____

Kategoria e Punimeve: RIPARIME TE VOGLA NE SHTRESA, BANKINA DHE STRUKTURA

| Zeri Nr. | Pershkrimi | Sasia | Njesia | Cmimi | Vlera |
|---|--|-------|--------|-------|-------|
| 3.1 | Sigurimi, shtrimi dhe ngjeshja e asfaltit me penetrim apo asfaltit te parapergatitur, ne gropat e pergatitura. (Shih shenimin me poshte) | 8 | muaj | | |
| 3.2 | Sigurim, shtrim dhe ngjeshje perpunimit sipërfaqësor me Dy Duar ne te nxehte. | 1000 | m2 | | |
| 3.4 | Sigurimi, shtrimi ne gropa dhe ngjeshja e makademit te lidhur me uje te aprovuar, per te krijuar shtresen baze te rruges. (Shih shenimin me poshte) | 8 | muaj | | |
| 3.5 | Sigurimi, shtrimi ne gropa dhe ngjeshja e zhavorrit/granilit, per te riparuar karrexhaten dhe bankinat. (Shih shenimin me poshte) | 8 | muaj | | |
| 3.6 | Kryerja e riparimeve te vogla ne strukturat prej tulle ose guri me llac cemento 1:3 | 10 | m3 | | |
| 3.7 | Kryerja e riparimeve te vogla ne strukturat e betonit. | 33 | m3 | | |
| 3.8 | Sigurimi dhe ljerja me boje te bardhe te aprovuar te shenjave dhe strukturave rrugore. (Shih shenimin me poshte) | 200 | m2 | | |
| 3.9 | Riparim trotuare betoni ose me pllaka betoni. | 300 | m2 | | |
| 3.10 | Riparim bordura betoni. | 100 | ml | | |
| 3.11 | Riparim puseta KUZ dhe KUB si dhe zevendesimi i kapakeve te pusetave | 68 | cope | | |
| 3.12 | Zevendesimi i sinjaleve vertikale komplet (tabela, boshti, aksesore, etj) | 15 | cope | | |
| 3.13 | Riparim dhe zevendesim i shtyllave elektrike te ndricimit dhe te llampave ne rruge | 5 | cope | | |
| 3.14 | Sigurimi dhe zevendesimi i mbrojteseve metalike (guardrail) | 15 | ml | | |
| 3.15 | Sigurimi dhe ljerja me ngjyra te pershtateshme te gureve te kilometrazhit, tabelave drejtuese dhe shenjave te trafikut. Perfshi te gjitha figurat dhe germat. (Shih shenimin me poshte) | 20 | cope | | |
| Totali i Mbartur ne Tabelen Permbledhese | | | | | |

Shenim: Aktivitetet e mesiperme qe kane te bejne me Punimet Rutine te Listes 3 (zerat 3.1, 3.4, 3.5,) duhet te perseriten, nese eshte e nevojshme, gjate kohezgjatjes se Kontrates (shih Specifikimet, Klauzola 1201 “Qellimi”).

Aktivitetet e mesiperme qe kane te bejne me Punimet Rutine te Listes 3 (zerat 3.2, 3.6 3.7, 3.9, 3.10, 3.11, 3.12, 3.13, 3.14,dhe 3.15) jane me matje dhe do te realizohen gjate zbatimit te kontrates ne perputhje me planin e puneve, dhe si do instruktohet nga Supervizori.

Pagesa mujore, per secilin nga zerat e punimeve, duhet te percaktohet nga Tenderuesit mbeshtetur ne inspektimin e seksioneve rrugore te kesaj kontrate dhe ne vleresimet profesionale te Tenderuesit per nivelet e nevojshme te nderhyrjeve per te mbajtur nivelin e drenimit dhe rrugen ne nivelet e percaktuara ne Specifikimet, Seksioni B.1. kontraktori duhet te kete ne konsiderate qe pagesa mujore eshte fikse sa ajo e ofruar ne oferte pavarasisht nga niveli I mirembajtjes qe do kerkohet gjate zbatimit te kontrates (shih specifikimet Kaluzola 1201 per Programin mujor te punimeve).

LISTA Nr.8

Kontrata Nr. _____

Kategoria e Puimeve: DITE-PUNE

| Zeri Nr. | Pershkrimi | Sasia | Njesia | Cmimi | Vlera |
|--|-------------------------------|-------|--------|-------|-------|
| 0 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 8.1 | Punetoria | | | | |
| 8.1.1 | Punetore | / | ore | | / |
| 8.1.2 | Pergjegjes | / | ore | | / |
| 8.2 | Materialet | | | | |
| 8.2.1 | Zhavorr natyral 0-32 mm | / | m3 | | / |
| 8.3 | Paisjet | | | | |
| 8.3.1 | Kamioncine (Pick-up) | / | km | | / |
| 8.3.2 | Kamion veteshkarkues 8-12 ton | / | km | | / |
| 8.3.3 | Fadrome 0.4 – 1.0 m3 | / | ore | | / |
| 8.3.4 | Grejder 45 – 75 kW | / | ore | | / |
| 8.3.5 | Rul Vibruet 1 ton | / | ore | | / |
| 8.3.6 | Ekskavator, 0.4 – 1.0 m3 | / | ore | | / |
| Totali i Mbartur ne Tabelen Permbledhese te Preventivit 8: Ditepune (3% te cmimit se kontrates. Te llogaritet ne tablen permbledhese) | | | | | |

Shenim: Kontraktori duhet te vendose cmimet njesi per punimet qe do kryhen me ditepune.